

EMIL LAFE

E FOLMJA NIKAJ-MËRTURIT

Nikaj-Mërturi është një krahinë malore në pjesën veri-lindore të Shqipërisë e rrethuar nga Lindja, Veriu e Perëndimi prej vargmalesh të larta dhe nga Jugu prej Drinit, i cili këtu e ka

çarë rrugën përmes një lugine të thellë me faqe të thepisura. Krahina ka një karakter të theksuar malor; në të gjenden maja të larta si Maja e Hekurave (2580 m.) (vendësit i thonë Maja e Hekrës — sipas gojëdhënës Noeu këtu hodhë "Hekrën" dhe qëndroi barkën e tij), Gryk'e Hapt (2625 m.), Maja e Dhive (2332 m.), Çardaku i Kakis (1859 m.), Korja e Mërturit (1759 m.) e shumë maja të tjera që shkojnë nga 1000-1500 m.¹⁾

Nga këto maja të larta ku zë dëbora dëborën zbresin përrenj e lumenj alpinë si lumi i Currajt e Epër, lumi i Mërturit etj. Kjo pasuri ujrash gjer tani shfrytëzohet vetëm për ujtitje e për mullinjtë e shumë

të, të cilët këtu janë pa ruajtës dhe u përkasin lagjeve o vllaznive që i ndërtojnë. Pyjet nuk janë fort të dendura. Në lartësi të mëdha rriten bredhi, pisha, ah. Pranë katundit Shëngjergj ka pyje gështenjash. Rriten gjithashtu bingu e bliri. Pemë frutore ka pak ose aspak — ndonjë man, ndonjë qershi, ndonjë kumbull. Katundet që janë ulët më ndonjë luginë kanë edhe nga pak hardhi.

Nikaj-Mërturi është një trevë pothuajse e veçuar. Lidhet me krahinat përreth nëpërmjet qafash të larta nga të cilat kryesoret janë: Qafa e Kolçit që të nxjerr në qytetin Bajram Curri, Qafa e Agrit që të nxjerr në Shalë dhe Qafa e Derzës që të nxjerr në Theth. Më parë nëpër Qafën e Kolçit e të Agrit shkonte rruga që lidhte Kosovën me Shkodrën. Sot, me hapjen e rrugës Shënmëri-Bajram Curri e me shndrimin e këtij qyteti në qendër ekonomike e administrative të rrethit të Tropojës, Qafa e Kolçit është bërë



1) Këto lartësi janë dhënë: për Majën e Hekurave sipas P. Geço: "Shqipëria" Tiranë; 1959, f. 13, për majat e tjera sipas hartës së Shqipërisë 1:300.000 Fotuar nga Istituto Geografico De Agostini Novara 1939.

më e rrahura. Nëpër Qafën e Agrit e përmes Shalës shkonin gjer vonë, për të bërë pazarin në Shkodër, shumica e malësorëve të Nikaj-Mërturit. Rruga për Theth nëpër Qafën e Derzës është më pak e rrahur, e pakalueshme për kafshët e barrës dhe humbet në pyll. Por që kur u hapën në Theth dyqanet e kooperativave të konsumit, shumë malësorë, sidomos nga Currajt e Epër, shkojnë atje për të shitur prodhimet e tyre blegtorale e për të blerë artikuj të nevojshëm industrialë. Dimërit këto qafa janë të pakapërcyeshme nga dëbora dhe rrugët rrezikohen nga ortiqet që bien dëndur, duke shkakëtuar ndonjëherë edhe viktima. Qafa e Dorçës, Gryk'e Hapt dhe Qafa e Ndërmajnave kanë një rëndësi të dorës së dytë. Mbi lumin Drin në këtë zonë nuk ka asnjë urë dhe kalimi bëhet me argsht ose me ndonjë trap a lundër.

Nikaj-Mërturi nga Lindja e Veri-Lindja kufizohet me Krasniqen, nga Perëndimi e Veri-Perëndimi me Shalën, nga Jug-Perëndimi me Toplanën e nga Jugu me Mërturin. Banorët nuk formojnë një njësi etnike. Nikaj e Mërtur janë dy fise të ndryshme që bashkëjetojnë në këtë trevë që prej shtatë-tetë brezash¹⁾. Të dy fiset janë të fesë katolike. Nikajt e quajnë veten vëlla me Krasniqen (sot musulmane) dhe prej andej kanë ardhur në viset që mbajnë sot, kurse Mërturasit janë shkëputur nga vëllezërit e tyre në jug të Drinit. Atdheu i parë i gjithë fisit të Mërturit ka qenë Rrafshnaltë e Dukagjinit mesjetar¹⁾, kurse fisin e Krasniqes tradita popullore e bën të ardhur nga anët e Malit të Zi.

Këto fise u shpërngulën për në viset që mbajnë sot duke kërkuar kullota për tufat shumë të mëdha (siç thotë gojëdhëna) të bagëtive të tyre. Përpara këtij imigracioni kjo zonë nuk ka qenë e zbrazët. Këtë e dëshmojnë disa varre, të cilat as Nikajt as Mërturi nuk i njohin për të tyret. Nuk dimë se ç'ka qenë kjo popullsi që u shpërngul ose u asimilua. Kështu sot në këtë trevë banojnë pranë e pranë dy fise të ndryshme, që, në pikëpamje gjuhësore, me kohë kanë formuar një farë njësie. Në hartë kufiri që ndan Nikaj e Mërtur është shënuar me një vijë të copëzuar: në veri të saj është fisi i Nikajt në jug fisi i Mërturit. Nuk dihet të ketë pasur ndonjë emigrim ose imigrim të mëpastajmë.

Duke qenë Nikaj e Mërtur dy fise të ndryshme, ata lidhin krushqi ndërmjet tyre, po shpesh herë edhe me Shalën. Përbrenda fisit nuk martohen kurrë se quhen që të gjithë motra e vëllezër. Gjer më sot kjo traditë nuk është thyer asnjëherë. Me Krasniqen nuk lidhin krushqi, se është musulmane, po edhe sikur të ishte katolike, Nikaj e Krasniqe nuk do të martoheshin se janë një fis. Nikaj-Mërturi është pra dhe kufiri lindor i katolicizmit në Malësinë e Mbidrinit. Duke qenë të lidhur ekonomikisht e administrativisht gjer më 1912 me një krahinë musulmane si Gjakova e Malësia e saj, malësorët e Nikaj-Mërturit, për t'i shpëtuar përbuzjes e diskriminimit nga pushtuesi i huaj ose fanatikët vendas, merrnin një emër musliman si Qerim, Hasan, Tahir, Smajl etj. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në krahina të tjera të vendit tonë, si p.sh. në Shpat të Elbasanit, por në rastin tonë emri musliman e ka nxjerrë, si të thuash, krejt jashtë përdorimit emrin e parë katolik të pagëzimit. Si llagap malësorët e Nikaj-Mërturit përdorin emrin e atit; ja disa breza të një familjeje: Vuksa Preka, Lulash Vuksani, Zymer Lulashi, Dod Zymeri, Kol Doda, Gjelosh Kola.

Para vitit 1912 Nikaj-Mërturi varej administrativisht nga Gjakova, e cila hynte në vilajetin e Kosovës. Gjakova ishte njëkohësisht dhe tregu kryesor ku shkonin malësorët e kësaj krahine për të shitur prodhime blegtorale e bagëti dhe për të blerë drithë e të tjera mallra të nevojshme. Por ky

1) Sipas një kumtimi të Rr. Zojzit.

qytet mbeti jashtë kufive që iu caktuan Shqipërisë më 1913 dhe Nikaj-Mërturi u lidh me Shkodrën, e cila u bë dhe tregu kryesor, ndonse tri ditë rrugë larg. Mbas çlirimit Nikaj-Mërturi ka qenë lidhur për disa kohë me Kukësin, kurse sot është një lokalitet i rrethit të Tropojës. Qendra e këtij rrethi është qyteti i vogël Bajram Curri, i ndërtuar në vendin e katundit Kolgecaj të Krasniqes.

Lokaliteti i Nikaj-Mërturit ka si qendër katundin e vogël Lekbibaj. Numri i katundeve nuk mund të caktohet prerë. Shumë herë lagjet merren si katunde e katundet si lagje, sepse shtëpitë janë shumë të shpërndara. Dy skajet e një katundi janë shpesh herë shumë më larg me njeri tjetrin se sa me shtëpitë e para të katundit fqinjë. Sipas ndarjes së fundit administrative lokaliteti i Lekbibajt ka 12 katunde: Bëtosha, Brica, Curraj i Epër, Curraj i Poshtër, Gjonpepaj Lekbibaj, Palçi, Peraj, Qereç-Mulaj, Salca, Shëngjergji, Tetaj. Katundi Rajë (pas çlirimit me kërkesën e banorëve është quajtur Bregu i Lumit), megjithëse është Mërtur, varet, për arësye gjeografike, nga lokaliteti i qëndrës.

Banorët e Nikaj-Mërturit merren me blegtori e bujqësi. Rrisin më shumë dhen, dhi, po edhe lopë. Kafshët e barrës janë të rralla. Gjatë dimrit, i cili atje zgjat shumë, bagëtia qëndrojnë të mbyllura nëpër ahuret e ushqehen me barin e gjethet që ka mundur të sigurojë malësori, kurse verës ngjiten në bjeshkë ku ka kullota të pasura. Toka e bukës është e pakët dhe jo pjellore, por malësorët e punojnë me kujdes, e plehërojnë mirë, "qesin torishtën" dhe e vadin sa herë të jetë nevoja. Mbillet pothuajse vetëm misër dhe me shërbimet që i bëhen jep prodhim të mirë, por nga toka e pamjaftueshme shumë familje nuk arrijnë të sigurojnë bukën e vitit. Për shkak të karakterit të theksuar malor të vendit nuk janë ngritur kooperativa bujqësore. Këto dhjetë-dymbëdhjetë vjetët e fundit është shpyllëzuar fusha e gjerë e Cernicës në jug të qytetit Bajram Curri dhe në tokat e hapura është ngritur edhe një kooperativë bujqësore me malësorë nga Nikaj-Mërturi. Kanë zbritur më fort ata që kanë pasur fare pak tokë, po rrallë herë ka ndodhur që të jetë shpërngulur e gjithë familja. Zakonisht njeri vëlla ka mbetur në trojet e të parëve me tufën e bagëtive. Shumë malësorë punojnë edhe në minierën e kromit në Kam. të Tropojës.

Shkollat e para në Nikaj-Mërtur ka rreth dyzet vjet që janë hapur. Sot ka edhe një shkollë shtatëvjeçare në Gjonpepaj. Folklori i krahinës është mjaft i pasur. Çdo luftë çdo ngjarje historike, çdo dëshmor i atdheut është përjetësuar me këngë. Ka shumë rapsodë që këndojnë trimëritë e Mujos e të Halilit dhe variante të këngës së Gjergj Elez Alisë. Këto këngë përcilleshin me lahutë, por sot kjo vegël muzikore është bërë mjaft e rrallë. Ja ka zënë vëndin çiftelia që bëhet më lehtë dhe është më e thjeshtë në përdorim. Çiftelinë ta zë syri në çdo shtëpi.

Ngrehinën ku banojnë malësorët e quajnë kullë, por thonë "j'âm tu shpija", "j'âm ka shkoj te shpija" e kurrë "j'âm tu kulla" etj. Kullat janë dy katesh: i pari është "ahri" për bagëtinë e kati i dytë për njerëzit.

Veshjen kombëtare sot e ruajnë pjesërisht gratë, shumë prej të cilave rrinë me zhupetë, një petk në formë të xhubletës së Malësisë së Madhe, po më i vogël dhe jo aq madhështor. Burra me tirq rrallë të zë syri, përveç ndonjë plaku të moçëm.

Kjo skicë e së folmes së Nikaj-Mërturit është hartuar në bazë të materialit dialektor që kemi mbledhur në vend gjatë një ekspedite prej 5-12-VII-1960. Ekspedita ka kaluar nëpër katundet Shëngjergj, Curraj i Poshtër, Gjonpepaj, Peraj e Curraj i Epër. Nga sa vëzhguam në vend e nga materialet e mbledhura, e folmja e krahinës paraqitet unike, pa dallime të theksuara nga katundi në katund o nga një grup katundesh në një tjetër. Vetëm malësorët, të cilët në përgjithësi kanë një ndjenjë të mprehtë gjuhësore dhe janë në gjendje të japin të dhëna për të folmet e tjera përreth, na kanë pohuar gjithashtu i kemi pyetur se katundet e Nikaj-Mërturit flasin të gjitha gati krejt njësoj. Në këtë mes ata veçojnë Brisën, katundin më perëndimor, për banorët e së cilës thonë se flasin pak si Shala (shih dhe tekstin në f. 144). Materialin e kemi mbledhur duke drejtuar pyetje sipas kuestionarit e duke regjistruar bisedat spontane të malësorëve në arrë, në shtëpi, rrugës ose tekste më të gjata dhe këngë. Subjektet kanë qënë kryesisht burra të moshës së vjetër e të mesme dhe me të dhëna të favorshme për të mbledhur prej tyre material dialektor. Veçse duhet ditur se në tërë krahinën nuk gjen burrë që të mos ketë dalë jashtë saj jo një herë e dy jo për një kohë të shkurtër. Arësyeja kryesore ka qënë dhe është shërbimi ushtarak.

Në këtë ekspeditë ne u ndodhëm përpara një ligjërimi që s'kishim pasur rast ta dëgjonim më parë. Ndonjë studim ose materiale dialektore të botuara për ato anë nuk ka¹⁾. Folklori i publikuar i asaj krahine paraqitet i stilizuar në pikëpamje të fonetikës. Në këto dhjetë vjetët e fundit është mbledhur një material i gjerë folklorik nga Q. Haxhihasani, të cilin e falenderojmë për këshillat e sugjerimet që na ka dhënë para e pas ekspeditës sonë²⁾. Ligjërimi i Nikaj-Mërturit nuk bie rëndë në vesh dhe kuptohet pa ndonjë vështirësi. Në sistemin vokalik nuk ka ndonjë inovacion me rëndësi; disa zhvillime që janë vërtetuar në konsonantizëm kapen që në minutat e para të bisedës. Burrat flasin ngadalë e shtruar. Kryengritjet e mëdha të Kosovës, luftërat e rrepta kundër Turgut Pashës në Qafë të Kolçit e në Qafë të Agrit, rezistencën e fortë të Bajram Currit etj. i tregojnë sikur t'i kishin përpara syve malet, shpellat, gurrët, lisat, armët e vjetra e shokët e vrrarë a të plagosur më të majtë e më të djathtë.

Me shqyrtimin e materialeve dialektologjike të mbledhura në atë krahinë ne i vumë vetes si detyrë hartimin e një skice dialektologjike informative përshkruese që të japë karakteristikat më spikatëse të së folmes. Nga fundi i majit të vitit 1963, gjatë një qëndrimi prej katër ditësh në qytetin Bajram Curri, patëm rast të mbledhim edhe disa materiale të tjera dialektolore pjesërisht prej malësorësh që dirgjeshin nga katundet për punë të ndryshme, pjesërisht prej atyre që janë shpërngulur në Cernicë. Në bazë të këtyre materialeve u plotësuan e u rishikuan disa pika të kësaj skice.

1) M. Lamberti na ka lënë nja dy vrejte shumë të shkurtëra mbi grupet *mb*, *nd* e bashkëtingëlloren *q* për katundin Rajë (Shih: Anzeiger der K.K. Akad. der Wiss. in Wien, Phil.—hist. Cl. 1916, Nr. XX).

2) Nikaj-Mërturi është një nga vatrave kryesore të Ciklit të Kreshnikëve. Një pjesë mjaft e madhe e rapsodive të këtij cikli janë mbledhur në këtë krahinë, sidomos në Currajt e Epër. Çdo fshat ka rapsodët e vet. Shqohen veçanërisht Dedë Zefi nga Currajt e Epër e Sokol Martini nga Brisa. (Shih: Q. Haxhihasani, "Rezultatet e kërkimeve të Ciklit të Kreshnikëve pas çlirimit" Kumbësë në konferencën e I-rë të studimeve albanologjike, Tiranë 1962).

Falënderojmë etnografët Rr. Zojsi dhe A. Dojaka për informatat e vlefshme etnografike që na kanë dhënë dhe arësimtarin Ndue Gjoka nga Bëtosha për ndihmën e tij në terren.

Tabelë e shenjave të përdorura në këtë punim ¹⁾

- é — zanore e patheksuar midis e-së e ë-së.
 q̄ — bashkëtingëllorja q e shqiptuar si frikative dhe pak më e përparme.
 ḡ — bashkëtingëllorja gj e shqiptuar si frikative dhe pak më e përparme
 š — një sh paraqellëzore e ardhur nga zbutja e afrikatës ç.
 ž — një zh paraqellëzore e ardhur nga zbutja e afrikatës çh.

F O N E T I K A

I Vokalizmi

1. *Kuantiteti i zanoreve të theksuara.* Edhe në të folmen e Nikaj - Mërturit, si në shumicën e të folmeve të gegërishtes, zanorja e rrokjes së theksuar ka tri shkallë gjatësie: shkurtësi, gjatësi të mesme dhe gjatësi.

Është e shkurtër përgjithësisht zanorja e rrënjës të foljet e zgj. I e II në rrokje të mbyllur nga një bashkëtingëllore çfardo me përjashtim të likuideve p.sh. (ti, ai) *dhez, ec, ik, lag, lidh, mbyt;* (unë) *pres, qes,* (ti, ai) *pret, qet* etj. Në rrokje të hapura si (unë) *dhezi, eci,* (ne) *dhezim, ecim* etj. kjo zanore ka gjatësi të mesme, ndërsa në trajtën e pjesores bëhet e gjatë, si rrjedhim i rënies së -ë-së fundore: *dhëz, ec, ik, tåg, līdh* etj. Është e shkurtër zanorja á° te folja *jám, kám* dhe zanorja u te ndajfolja *kurr*.

Shumicën e zanoreve, që në këtë dialekt sot dëgjohen të gjata, e përbejnë ato që kanë pësuar një zgjatim kompensator, kur ka rënë -ë-ja fundore, p.sh. *bīr, bucēl, dāj, djūth, dōr, gūc, kāl, kēp,* (qepë), *tōp, kūll, dy pshjellāk, pūl, dy shōk, tūf* etj. E njëjta gjë ka ndodhur edhe te pjesoret që dikur kanë mbaruar me -ë e -në: *djēg, djērg, līdh, mār, mbjēll, mbūsh, ndāl, sōs, llomīt, pjās, pvēt, qīt, vllašīt; dhān, kān, thān, zān* etj.

Të tjera raste gjatësie:

a) në rrokje të mbyllur nga bashkëtingëllorja -r p.sh. *katundār, kumbār, lavértār, shiptār, žandār* etj.

b) në rrokje të hapur të fjalët *gū* (gju), *kušī, malsī, mī, mullī, Shipnī, thī, thmī* etj. Po ashtu edhe në rasat e zhdrejta *malsīs, malsīn, shpīs, shpīn*.

c) te parafjalët *kā* e *pā* p.sh. *kā i kem kta mashkuj? kā je ka ve* (vete)? *jám kā shkoj Kolgeaj; pā būk, i pāshkōll, i pātyrp, katunde t'pāvadea* etj.

ç) te foljet *jē* dhe *kē*. Në të tanishmen e dëftores zanorja -e e foljes *kē* është zberthyer duke dhënë grupin zanor *ie: ti kie*, por, kur shërben për të formuar trajtën e vetës së tretë të së pakryerës, kjo -e ka mbetur e pazberthyer dhe dëgjohet e gjatë, megjithse në rrokje të patheksuar p. sh. (ai) *ardhkē, bakē, u dashkē, marrkē, ndejkē, thānke* etj.

d) te numërori *dīj* para një emri të gjinisë femërore: *dīj dele, dīj kīsh, dīj šika* etj.

dh) te përemri vetor *nē* (dhanore, kallëzore) dhe te përemrat dëftorë (*i, e*) *atī, (i, e) ktī* (gjindore, dhanore).

Ngandonjëherë gjatësia është rezultat i një kontraksioni p.sh. *lē* (<le+e), *gē* (<gjae), *ngē* (<ngae), *vrē* (<vrae).

2. *Nazalizmi.* Në këtë të folme nazalizmi i fshik tërë zanoret, por,

1) Për arësye teknike nazalizmi është shënuar me dy shënja: ▲ e ◡.

si kudo që çfaqet ky fenomen, më e fshikura nga shoqet është *a-ja*¹⁾. Në këtë të folme *a-ja* hundore është edhe e labializuar. Kur bashkëtingëllozja hundore përpara saj ka rënë, ajo ndihet gati si *ô* p.sh. *ôsh*, *khô*, *njô me tô* (me të), *n'tô* (në të); në raste të tjera ndihet si *â* p.sh. e *âma*, *Frâ^onca*, *gêrhâ^on*, *hâ^ona*, *me hâ^ongêr*, *jâ^om kâ^on*, *kâ^omba*, *lâ^omsh*, *i shaljâ^oni*, *zâ^oni* etj. Shkalla e ndryshme e labializimit të *a-së* mund të spiegotet me intensitetin më të madh të nazalizmit, kur bie bashkëtingëllozja hundore, në krahasim me rastet kur kjo bashkëtingëllore shqiptohet.

Në përgjithësi kemi zanore hundore në këto raste:

a) para një bashkëtingëlloze hundore (*n*) që ka rënë kudo p.sh. *ô*, *ôsh*, *dhêt* (dhentë), *mêt* (mëntë), *pês*, *n'fût* (në fund), *û* (unë) etj., ose që ka rënë vetëm në trajtën e pashquar të disa emrave, p.sh. *zâ^oni*, *frê^oni*, *pê^oni*, *blî^oni*, *brî^oni*, *Drî^oni*, *mullî^oni*, *gû^oni*, *hû^oni*, *dry^oni*, *sÿ^oni*, etj.

b) para një bashkëtingëlloze hundore që nuk ka rënë, (*m, n, j < nj*) p.sh. e *âma*, *gêrhâ^on*, *hâ^ona*, *jâ^om kâ^on*, *lâ^omsh*, *i shaljâ^oni*, *nên*, *vên*, *zôj* 2) (nga zonjë), *ûn* (urë zjarri), *frÿma* etj.

c) para një grupi *mb*, *nd*, *ng*, p.sh. *me hâ^ongêr*, *kâ^omba*, *bun^s hûn^d*, *katund*, *kurrkund*, *krymba* etj.

ç) pas një bashkëtingëlloze hundore, p.sh. *kamîsh*.

Intensiteti më i fortë i nazalizmit ndihet në ato raste kur bashkëtingëllozja hundore që ka shkaktuar këtë fenomen nuk shqiptohet më, kështu *ô* të *ôsh* është më nazale se *â* të *hâ^ona*, *ê* të *pês* është më nazale se *ê* të *vên*, *ÿ* të *sÿ* është më nazale se *ÿ* të *sÿni* ose të *frÿma*.

Për katundin Brisë që ndodhet në skajin më perëndimor të kësaj krahine, ku, për fat të keq, s'patëm mundësi të shkonim, disa malësorë prej katundesh të tjera na thanë se brisjanët flasin *mâ me hûn^d se na*, si *Shala*. Ndodhëta midis Shalës e Nikaj-Mërturit kalon kufiri që i ndan të folmet e Mbidrinit për nga intensiteti i nazalizmit.

Është për t'u vënë re në këtë të folme se *a-ja* e theksuar përpara një bashkëtingëlloze hundore në fjalët me burim turko-arab është fshikur fare pak nga nazalizmi dhe aspak nga labializmi. Kështu thuhet: *nallbân*, *nizâm*, *Hasân*, *Ëelosh Râma* i *Râm Mehmetit*, *zami* (xhami) etj. dhe jo *nallbâ^on*, *hizâ^om* etj.

3. Disa diftongje. Njya e prapme *-u*, që marrin emrat e lakimit të dytë me temë në zanore dhe mbaresa *-u*, që marrin në vetën e tretë njëjës të së kryerës së thjeshtë disa folje të zgj. të III e të IV, formojnë me zanoren fqinjë diftongje të ndryshëm zbritës. P.sh.

au : *ka^u*, *shka^u* (serbi), *da^u*, *la^u*, *pa^u* etj.

eu : *dhe^u*, *le^u* (lyejti), *pre^u*, *the^u* etj.

iu : *thi^u*, *i zi^u* etj.

ou : *Kukel Ndo^u*, *i Shnando^u*, *go^u*, e *shkro^u* etj.

Në shumësin *k^ualt* kemi diftongun ngjites *ua*.

Diftongu ngjites *ie* del në shumicën e foljeve të zgj. I-rë që pësojnë apofoni në të kryerën *ê* thjeshtë. Në rrokje të hapur si (unë) *mbielli*, *tierr*, *vieli* etj. e është e gjatësisë së mesme, në rrokje të mbyllur si (ti, ai) *mbiell*, *tierr*, *viel* etj. zanorja e është e shkurtër.

Të tjera përpjekje zanoresh që formojnë diftong në mbarë shqipen

1) K. Cipo, "Gramatika Shqipe", Tiranë, 1949, f. 7.

2) Bashkëtingëllozja *-nj* hundore në këtë të folme është kthyer në *j*. (Shih më poshtë Konsonantizmin § 3).

ose në shumicën e të folmeve të saj, brenda fjalës ose në kushtet e fonetikës sintaktike, i kemi shënuar gjatë shembujve dhe në tekstet, por këtu na duket e tepërt t'i trajtojmë.

4. *Togje zanoresh.* Togjet zanore *ie, ue* dhe *ye* ruhen si në mes ashtu dhe në fund të fjalës dhe nuk janë monoftonguar si në shumicën e të folmeve të tjera të gegërishtes.

ie: diell, miell, qiell, u zien voet, me ndie, me zie etj.

ue: m'breg t' Buens, e besueshme (besimtare), krapuell, laknuer, muejt, puntuer, shkruej, truell, ftue, grue, hingllue, krue, potkue, mue, punue, shkrue etj.

ye: dyer, fyell, karcyell, kryet, tlyeni; me lye, me ngjye, me thye etj.

Togu zanor *ae* është kontraktuar në *e* ashtu si në të folmet veriperëndimore: *gae > gē, ngae > ngē*. Në trajtën foljore ti *pave* këtë tog zanor e ka ndarë në mes një *-v-* antihiatizuese. Kontraksioni *ae > e* ndodh edhe te folja *me vra* në mënyrën urdhërore v. II njëjës plus trajtën e shkurtër për-emërore *e vra + e > vrē*.

Togu zanor *oe*, që në të folmet veriperëndimore është kontraktuar në *ō* dhe në të folmet lindore në *o*, në të folmen e Nikaj-Mërturit ruhet si i tillë, p.sh. *kemi droe q'i na u ka zān prita, ni voe, shum voe, u zien voet* etj.

5. Zanorja që i përgjigjet *ē-sē* së patheksuar të shqipes së përbashkët në këtë të folme është një tingull në mes një *e*-je dhe një *ē*-je, të cilin grafikisht po e shënojmë me *ē*.

Në pozicion fundor kjo zanore ka rënë gjithkund, duke shkaktuar zgjatjen e rrokjes së theksuar. Në trup të fjalës gjendja paraqitet e tillë: zanorja *ē* ka rënë si përpara ashtu dhe pas theksit me përjashtim të rasteve kur është ndodhur në rrokje të mbyllur nga një sonore (*l, m, n, r*). P.sh.

ka rënë:

— para theksit: *bakti, Btōsh, mllex, shllung, vlla* etj.

— pas theksit: *prej ars, (i, e) nāns, rrugs, (i, e) shkoll, rreth tērvēz* etj.; *dimni, drapni, emni, tymni* etj.

është ruajtur:

— para theksit: *pēballim, pēfill, pēftim, dhimb, pērlyese, pērmjeti, i pērthim, tērthuer, tērvēsa,* etj.

— pas theksit: *āndēr, bagēl, fazēm, dorēn, duelēm, duelēn, i egēr, i epēr, eshtēn, fjetēm, fjetēn, folēm, folēn, fretēn, hapsanēn, hirēn, kokēr, lidhēm, lidhēn, lopēn, luftēn, misēr motēr, pushkēn, rrogēn, Shkodēr, shyetēn, vllazēn, i vorfēn* etj.

Sa herë që në kushtet e fonetikës sintaktike bashkëtingëlloerja sonore lidhet me një zanore tjetër që vjen pas, duke formuar me të një rrokje, zanorja *ē* nuk ndihet, p.sh. *martoj shikn e vet, e sūm hapsann e Shkupit* etj. Edhe kur ndodhet midis dy sonoresh *ē*-ja shpesh herë bie, krahas *duelēm, duelēn muerrēm, muerrēn*, thuhet rëndom: *duelm, dueln, muerrm, muerrn*. Zanorja *ē* është ruajtur dhe në disa rase kur me rënien e saj do të formohej një grup bashkëtingëlloresh i vështirë për t'u shqiptuar, p.sh. *zogu i koshēs, leshi i mjekrēs, ju nejtēt*; në disa raste shpifet një *ē* po për këtë arsye, p.sh. *haj t'marrtē drēqī, nukē m'dha* etj.

6. Pas bashkëtingëlloreve *d, g, l, q, sh* në pozicion protonik zanorja *ē*, si dhe në të tjera të folme, sidomos të gegërishtes, te disa fjalë është bërë *i*, p.sh. *me distue, me dishrue, me dishtue, me listue, me livrue, me qillue, me qirue, qirojs* etj. Po kështu edhe e ka kaluar në *i* në fjalët *gindē*, dhe *shiqēr*. Arësyeja e kësaj dukurie mund të jetë fqinjësia e një tingulli të shumtën e herës palatal siç janë bashkëtingëlloret *ē, ē, l, sh*.

7. Zanorja *i* në disa fjalë, sidomos kur ka pasur pranë një bashkëtingëllore buzore, ashtu si në shumicën e të folmeve të gegërishtes, është labializuar duke u kthyer në *y*, p.sh. *avytem, fyshëk, hyj, krymbë, me lypun, llastyke, ryp, sylahi*. Emri i shpendit *shqype* është me *y* ashtu siç e ka dhe Gjon Buzuku, në dallim nga emri i vendit e i popullit *Shipni, shipta* që janë me *i*. Për fjalët *frima* "era që fryn", *me fri* dhe *timi*, që në këtë të folme kanë *i*, etimologjia ende e pazgjidhur e tyre nuk na sqaron në kemi këtu ruajtjen e një *i*-je të vjetër apo delabializimin e *y*-së në *i*.

8. Zanorja *u* te fjala 'turp' është kthyer në *y*, thuhet pra *tyrp, i pātyrp*.

Zanorja *u* te fjala 'duket' është hapur në *o*, thuhet pra *m'doket, ai s'po doket atje* etj.

II Konsonantizmi

Në sistemin konsonantik të kësaj së folmeje janë për t'u vrejtur këto dukuri:

1. Bashkëtingëlloret qiellëzore *q* e *gj* e kanë humbur karakterin e tyre okluziv duke u kthyer në tinguj frikativë dhe pak më të përpamë, të vështirë për t'u transkribuar¹⁾. Prof. M. Lambertz në nja dy vrejte të shkurtëra që na ka lënë për të folmen e katundit Rajë (sot Bregu i Lumit) thotë ndër të tjera se atje bashkëtingëllorja *q* shqiptohet si "një tingull i ndërmjetëm në mes një s(-j) shumë të fortë dhe pa za dhe të një sh(-j) krejt pa za"²⁾. Në këta tinguj po i shënojmë me *q̇* e *ġ*, pra *q̇* : *q̇af, qeni, qerpiku, me q̇eth, q̇oshe, q̇ymyr, faq̇e, Krasniq̇e, piq̇et, knaq̇et, fëlq̇ia, kaq̇, i kuq̇, iriq̇, etj.* *ġ* : *gak, gash, gël, gëta, gini, guni, briqe, Dukaq̇ini, king, kong, etj.*

2. Afrikatat *ç* e *zh* në këtë të folme janë shndëruar në tinguj frikativë dhe tingëllojnë e para si *sh*, e dyta si *zh*, po më palatale se *sh* e *zh* origjinare. Në transkribim këta tinguj po i japim me *ś* e *ż*.

ś : *śje ka thue, śa ke pru, śaj mali, śakalla, śaranik, śarapi, śardak, śarśaf, śilsi, śile derën, śika jeme, u śuen n'kã^om^b, kopaśi, kośak, pëlśik, turśe, me vllaśit, boś, pers, veś, vllaś* etj.

Në brezin e ri e në të mesmin nën ndikimin e shkollës, shtypit dhe formave të ndryshme të arësimit politik, pa lënë mënjanë shërbimin ushtarak, vrehen dhe lëkundje nga norma e së folmes p.sh.

rrnoft partia e Leninit/ si çon popujt drejt socializmit/

ż : *żami, żamia, żamedãⁿ, żandã^r, żupet, gërżepi, ożaku, harz, miz* etj.

3. Sonorja nazale *nj* është jotizuar në mes e në fund të fjalës, por zanorja përpara saj shqiptohet si hundore p.sh. *fij, i shtrëjt, e ka shkul me gij rrãj, ukija, zõj* etj.

Në fjalën *një* të përdorur si mbiemër numëror bashkëtingëllorja *nj* është depalatalizuar p.sh. *ni baloz, ni delme, ni pllã^m e ni pelsik, dhe u nis për l'gat ni shpatit* etj., por është ruajtur te numërori *njõ* (sa djet kie? — *njõ*), te përemrat e pakufishëm *asnjõ, kurrnjõ* e te ndajfolja *nja*.

4. Ndërdhëmborja *th* është këmbyer me buzore-dhëmboren *f* në fjalët *fell* e *ufull*, e kundërta ka ndodhur në fjalën *thmi* (fëmijë), fjala *thër* (ferrë) del këtu me *th*-nistore ashtu si folja *ther*.

5. Bashkëtingëllorja *dh* në disa fjalë ka kaluar në *ll* p.sh. *llall* (dhallë), *me rrall, llom*.

1) Ky fenomen është i përhapur edhe në të tjera të folme të gegërishtes veriore e lindore; për këtë shih: J. Gjinari "Dialektologjia Shqiptare" (Dispensë) Tiranë 1963, f. 39; A. Dodi "Fonetika e gjuhës së sotme shqipe" (Dispensë) Tiranë 1963, f. 41.

2) Maximilian Lambertz. — Raport mbi diskutimet e mia linguistike në Shqipëri prej mezit të majit deri në fund të gushtit 1916 (përkthimi i pabotuar ruhet në Arkivin e Institutit të Historisë e Gjuhësisë), f. 18.

6. Disa herë bashkëtingëllorja *l* ka kaluar në *ll* në fjalë si *llubenica* (sll. *lubenica*), *pllug* etj.

7. Spirantja *s* është kthyer në *c* në fjalët *cill*, *lypca*, *nemaja*, *therc* (halë gruri), por është ruajtur te foljet *kërset*, *pëlset*.

8. Në fjalët *kēp* (qepë), *me kēp*, *keprā*, *kerr* (qerre), *t'keshin mileti*, *kime*, *llēai* kemi bashkëtingëlloren *k*, ashtu si në gjithë gegërishten verilindore, kurse dialektet e tjera të shqipes këto fjalë i kanë me *q*¹⁾.

9. Faringalja *h* dëgjohe mirë në të gjitha pozitat dhe në fund fjalë nuk alternohet me buzore-dhëmbore *f*: *hap*, *harap*, *i huej*, *hunda*, *duhet*, *guha*, *vjehër*, *njoh*, *njeh*, *kōh*, *krah*, *leh*, *shoh* etj.

Grupe bashkëtingëlloresh

1. Grupet *kl* e *gl* në këtë të folme kanë pësuar një velarizim të plotë ashtu si në krejt gegërishten veri-lindore. Pra:

kl > k: *me kajt*, *mos rake tash shiu* | *ke m̄r*, *kosh me ndēr*, *kumshti*, *shkebza*, *me shkÿe* etj.

gl > g: *djali i ka ga babs*, *i gāt*, *dhe u nis për t'gāt ni shpatit*, *gāndra*, *gob*, *t'gobiti*, *guha*, *gūni*, *me ndigÿe*, *me zgidh* etj.

2. Grupet *bl*, *pl* e *fl* janë zbutur në *bj*, *pj* e *fj*. P.sh.:

bl > bj: *bjeta*, *i bjeshim n'Karadak*, *mbjidhet*, *me bjue* etj.

Kemi dëgjuar me grup *bl* fjalët *blī* e *mbloja*. Në brezin e ri e pjesërisht në të mesmin, ndonjë fjalë nga sfera ekonomike politike shqiptohet me *bl* p.sh. *me ble*, *mbledhje*.

pl > pj: *pjafa t'lesht*, *pjagosin*, *pjak*, *i pjakun*, *s'un e nxjerri germen e vogël me pjās*, *Pjav*, *pjeh*, *pjep*, *pjeq*, *pjānc*, *pjot*, *pjumb*, *kumpjet* (komplet), *shpjāk* (shuplakë), *me shpjue* (me zbulue) etj.

Por tek tuk dëgjohe edhe *pl* p.sh. *po plasin*, *burra pleqnar*, *kuprativën e kū* (kam) *pleqÿue*, *me i ra shptāk*, e *shplojn*. Ky grup ruhet gjithnjë te fjala *naplon* (njëqindlekshe).

fl > fj: *sjāk*, *sjaturojn*, *ū fjas*, *ti fjjet*, *na fjasim*, *po fjej*, *fjeni*, *asni fjjet sjjet*, *fjett e rrots*, *sjog gata* | *mend paka*, *sjutura* etj.

3. Grupi *lk*. Në tri fjalë që kemi mbledhur për këtë grup vrehen tri gjendje të ndryshme të tij: a) *lk* ruhet: *bulk*; b) është zbutur në *jk* (*jq*): *ajku*, *bujq* (në dallim nga disa të folme skajore të Jugut që ruajnë *lk* dhe në shumës: *bulq*; c) është velarizuar në *k*: *uk*, *uq*, *ukij*.

4. Grupet *mb*, *nd*, *ng*. E folmja e Nikaj-Mërturit në pozicion nistor e në trup të fjalës i ka ruajtur të paasimiluara këto grupe, kurse në fund të fjalës elementi i dytë dëgjohe zakonisht si i rëgjuar ose ndonjëherë s'dëgjohe fare. P.sh.

mb - e *mbajke* me i *ruejt baktin*, *mbas*, *me i mbath*, *mbërzia*, *mbesa*, *mbet*, *me mbjell*, *mbjidhet*, *mbloja*, *mbrapa*, *mbrenda*, *mbreti* etj.

mb - *bumburon*, *dymbdhet*, *kollomboq*, *përmbas*, *përmbi*; *shkembëz*, *thumba*, *umbini* etj.

mb : *m'dhem^b dora*, *dhim^b përlyese*, *pllamb^b*, *shkamb^b* etj.

Lidhur me këtë grup konsonantik M. Lambertzi ka shkruar se në Raje elementi i dytë i këtij grupi spikat fort në dëm të të parit: *mbret*, *mbyti*²⁾ etj. Nga ai katund kemi pasur vetëm një subjekt dhe nuk kemi konstatuar

1) C. Tagliavini (*Le parlate albanesi di tipo ghego orientale*, f. 56 v) shikon në këtë tip një analogji me fjalët ku *kl* paraqitet sot *k*, p.sh. *kumshti*, *kaj* etj.

2) M. Lambertz. *po aty* f. 48.

një gjë të tillë. E folmja e Nikaj - Mërturit në këtë mënyrë afrohet me gegërishten lindore të Gjakovës, e cila, siç shënon N. Jokli¹⁾, e ruan grupin *mb*. Edhe grupi *nd* sipas po këtyre dy dijetarëve për Rajën e Gjakovën ka karakteristikat e grupit *mb*, pra e folmja e Nikaj-Mërturit edhe në këtë pikë shkon me Gjakovën.

nd - : *ndāl s̄yt e ndāl vesht e bō hibret*, (lumi) *vjen e rritet e hi nd'ara, t'u rrit ndera, kosh me ndër, Lugu i Ndërmals, u ndëshka t'mirën, nuk ndin mir pa i fol t'madhe, ndoni, Kukul Ndou, nd'uj, ndushkon mali etj.*

-nd - : *n'laḡe t'andejme, ndër s̄j t'gind̄s, hund̄a, katund̄e, kran̄e, pendlat, i Shnandoṽ, thundra, yndyr thiut, e vndojm, zand̄ar etj.*

-nd̄ : *dyḡind̄, fund̄, katund̄, mānd̄, i pend̄ kije, i smund̄, vend̄ etj.*

Ndonjëherë këta dy grupe i kemi dëgjuar edhe si të asimiluar; grupin *mb* sidomos te fjala *tā°mël*, e grupin *nd* të fjala *nimoj* e te ndonjë tjetër.

Edhe grupi *ng* siç thamë në krye paraqitet njësoj si grupet *mb* e *nd̄*, pra : *ng- e ngarkuem kalin, nḡe, ngërmohe, u ngina, u ngri, i ngroht etj.*

-ng- a *kie hā°nger buk? kā°ngt e luftavet, kongall, lā°ngu etj.*

-nḡ *būnḡ, opā°nḡ, shllūnḡ.*

5. Grupi *nḡ* është ruajtur i plotë në të gjitha pozitat, p.sh. *me u nḡit n'bjeshk, me nḡye, kinḡi, kinḡ, kōnḡ, unḡu etj.*

6. Grupi *fsh* është asimiluar në *sh*. Veç fjalëve *shisa, e shijm shpin*, në të cilat *f*-ja nisëtores që ka sot gjuha letrare mendohet se është një prefiks²⁾, po rendisim këta shëmbuj të tjerë: *kashat, kosha, u ndiesha t'mirën, u rrashit kulla me bōr, teri m'pēs kashat, n'mos u ktheshim për tre vjet, kosh me ndër, u shurdhosh etj.*

Siç shihet ky asimilim është shtrirë dhe te dëshirorja e foljeve vokalike.

7. Grupi *ḡt*. Tingulli qiellëzor i këtij grupi është jotizuar pra *ḡt > jt* p.sh. *zojt e malit, nuk ḡejti* (<*ḡeḡti* = *gjegji*) *me ārdh* (nuk dëgjoji të vinte). Edhe në shumësin e pashquar të emrit *zog* për analogji me trajtën e shquar kemi *zoj* e jo *zōḡ* p.sh. *ukij me zoj.*

8. Edhe në grupin *shḡ* bashkëtingëllorja *q̄* është jotizuar p.sh. *jā°m kā ndjeku shjarrtha* (shqerërtha), por, kur pas *shq* vjen zanorja *i*, ky grup është reduktuar në *sh* p.sh. *shḡl* (<*shqile*), *Shipni, shiptār*³⁾.

9. Grupet *sḡ* e *zḡ* kanë përfunduar gjithashtu në *sj* e *zj* me jotizimie e tingujve qiellëzorë:

ka i sjap n'dit e lyp me ja rjēp, sjetulla, tezhahi.

Jotizimi i bashkëtingëllorëve qiellëzorë *q̄* e *ḡ* në grupet e sipërpërmen-
dur e ka burimin në shqiptimin e këtyre bashkëtingëllorëve si tinguj
frikativë të zhurmët⁴⁾.

1) N. Jokl, *Zur Erforschung der albanischen Mundart von Borgo Erizzo in Dalmasien* (Archivum Romanicum vol. XXIV, Nr. 1) f. 15.

2) A. Xhuvani - E. Çabej "Parashtesat e Shqipes" Buletin për Shkencat Shoqërore, Nr. 4, 1956, f. 71.

3) Siç po më kumton Menella Totoni edhe në Kurvelesh ndodh një fenomen i ngjashëm: grupi *xḡj > xj* p.sh. *xjeben, xjeth, i xjuar*, por kur pasohet nga një *i* kemi *xḡj > x* p.sh. *xith, xidhu*.

4) Shih A. Dodi, *po aty*, f. 41.

Fenomene Fonetike

1. *Elizioni*. Një rast interesant i elizionit është shuarja e zanores *o* të pjesëzës *po*, kur pas saj vjen trajta e shkurtër përemërore *e*. Kjo trajtë *p'e* ka marrë kuptimin e pjesëzës *po* dhe përdoret në vend të saj përpara trajtash të tjera të shkurtëra, siç dëshmohet në shembujt e mëposhtëm:

Kët katund^d fare p'e qesim /
Küll e shpija p'e jau djegim /
T'madh e t'vogël p'e jau presim //

ose

Dajma rokun në kto net /
Ndo p'e djeg katundin krejt //

ose

p'e ndien burrat e p'e na e vrasin /
ose p'e msojm, p'e ldiri bjetën, p'e ndjekum, pse s'p'e nxò, tash p'e pvesim etj.

Një rast tjetër elizioni është shuarja e zanores *e* te pjesëza të e lidhore, kur pas saj vjen trajta e shkurtër e¹⁾ p.sh.: *ama t'e lã°; medet t'e kena ni thmi; mos t'e thejn bora; për kur t'e pvetish; nimomni e t'e hjeki Mavriqin prej Currajsh s'Epçer; duhet t'e lã°sh katër sahat* etj.

2. *Asimilimi*. Asimilimi vrehet në disa fjalë të paka e në disa trajta fjalësh. P.sh.

a) asimilim bashkëtingëlloresh në kontakt:

mp > mb : *me mbreh, i mbreht;*

nt > nd : *t'linda* (nga të linta);

nz > nx : *u nxun ndër veti, nxònsi i mullinit, t'nxòn bjeta* etj.

sn > zn : *beznik, dazmor, dazmoresha, hazmin* etj.

tm > m : *prim dhe mue;*

b) fjalë me asimilim të distancë :

-në zanore: *katalik, shubuk* (çibuk), *grandavec, strufullog*, (strolfullog), *shajestra* (shejestra), *shalqan, tavalinat*,

-në bashkëtingëllore: *Balbon* (Valbonë), *furtere* (fultere).

3. *Disimilimi* është gjithashtu një fenomen i rrallë: *ladrojn* (<lodrojn) *llagor* (llagore), *t'kuntrullojn* (<t'kontrollojn), *undyr* (<yndyr). Disimilim në shkallën zero: *Kasrati* (<Kastrati).

4. *Metateza* në dialektet është një fenomen i shpeshtë dhe veç fjalëve të vjetra kap dhe shumë fjalë të reja që kanë hyrë nepërmjet shkollës e shtypit. P.sh. : *gallapi* (llagapi), *krpuell* (kapruell), *kshndija* (shkndija) *me ldır* (me dliř), *ndretesa* (ndërtesa), *përzore* (prezore), *pkuca* (këpuca), *pkutet* (këputet) *preson* (person) etj.

5. *Shtesa tingujsh*

a) *Proteza*. Në fjalën *i jati* është përftuar një *j* protetike në kushtet e sandhit, kurse te folja *ap, ep* kjo *j* mungon. Si tinguj të tjerë protetike gjejmë *m* para *b*-së e *n* sidomos para *d*-së p.sh. : *pa jarân mbijo nu jë, e mbylmojm, e ndrejt, ndushkon mali, ngushti* (gushti), *u nxun* (u zunë) *ndër veti, nxã°nsi* (vegla që ze ujët në mulli, zënësi i ujit).

b) *Epenteza*. Emrat e lakimit të tretë që në trajtën e pashquar mbarojnë me zanoren *e* ose *i* të theksuar, marrin midis temës e nyjës shquese një *-j-* antihiatizuese : *dhija, pleqñija, qeverija, Zef Sadrija, ushtriya, geja* etj. Shumë herë një *m* tërheq një *-b-* epentetike dhe një *b* tërheq një *-m*

1) Sipas një kumtimi të Prof. E. Çabejt një fenomen i tillë nuk dihej për gegërishten.

epentetike, p.sh.: *n' Mbëtūr, bumburōn* (babullin), *e ka lambrue, mbërzija*. Epenteza të tjera: *e shtunde* ¹⁾, *drangue, rrnesa, rroft* etj.

c) *Epitezë*. Fjala *man-i* në të folmen e Nikaj-Mërturit ndihet kudo si *mānd-i* ²⁾.

6) *Rënie tingujsh*

a) *Afereza*: *sha Zotin* ose *asha Zotin* (pasha Zotin), *s'un shkoj, s'un t'vret* etj.

b) *Sinkopë*: *gysa* (gjysma ose gjyma), *i kiellt* (i kthiellt), *mzika* (muzika), *naplona* (napolona), *pej* (prej), *thuer* (tërthuer), *vrem* (verem) etj.

Një rast i posaçëm sinkope është rënia e bashkëtingëllores -n përpara një sh-je ose një t-je fundore në këto fjale: *dhët* (dhëntë), *mët* (mëntë), *tāmël dhësh, duel mësh, n'ma dhësh* etj.

c) *Apokope*. Rastet më të rëndomta të apokopës janë: 1) rënia e bashkëtingëllores -n kur shërben si mbaresë vetore ose në disa emra njerëzish p.sh. *edhi lë i smund, ish kâ puno, ka jë kâ vje* (nga po vjen), (lumi) *hî nd'arâ; Hasâ, Shabâ, Shytâ* etj. 2) rënia e bashkëtingëllores s te pjesorja *pasë* në të kryerën e II-të e të kryerën e plotë të II-të: *kem pa jetue, ka pa ardh, kish pa thān* etj.; 3) rënia e bashkëtingëllores -k te pjesëza nuk p.sh. *nu jān ardh, nu mujtim, nu mun e pritëm* etj.; 4) rënia e -t-së fundore në disa fjale si: *pasha t'madhin Zo! Mehme Shpëndi, Mehme Binaku, me muj* (me mujt), *zymer* (xhymert) 5) rënia e zanores -i në v. II shumë të foljeve *jam e kam* kur përdoren si ndihmëse: *jem ardh, kem punue* etj. 6) te fjala *gjithë* bie bashkë tingëllorja -th: *me gi grue, i ka thye lisat me gi rrāj* etj.

Me rënien e tingujve që përmendëm janë krijuar ato që quhen "forma alegra", që i kanë nxjerrë pothuajse krejt jashtë përdorimit trajtat e plota të këtyre fjalëve.

7) Shurdhime e sonorizime.

Bashkëtingëllorja *d* te parafjala *deri* të shumtën e herës shqiptohet si *t* p.sh. *teri n'Gakov; teri u bôke akshâm; teri diq baba; e ngranshin teri m' pës kashat; teri m'gashit mbetshin tuj pi rakë; thirke teri m'tridhet vet* etj.

Bashkëtingëllorja *d* është shurdhuar edhe në fjalën *zill* (sll. *zid*).

Por shumë shpeshë ndodh dhe e kundërta: *t*-ja sonorizohet e bëhet *d*. Kjo është e rëndomtë te përemrat dëftorë e ndajfoljet përemërore kur marrin si parashtesë deiktike pjesëzën *qe* (dhe kjo ndodh shumë shpeshë) në vend të *kë*. P.sh. *qedi* (këtij), *qedo* (këtë), *qeda* (këta, asnjënesi), *qeda* (këta,) *qedo* (këto), *qedu* (këtu), po kështu *qedash* (tash). Ja disa raste përdorimi në fjali: *qedi i thona arra* (këtij druri i themi arrë); *ama qada shtalb* (ma jep ata shtalb), *qado vende me i zaptue; me kân i fort i ka thān i merr qeda; rrini gati qedu; qada si erdhen te na*, por edhe *ama bāb qetu*.

Bashkëtingëlloret e zëshme fundore në këtë të folme nuk shurdhohen.

M O R F O L O G J I A

1. *Asnjëanësi*. Si në mbare shqipen edhe në këtë të folme kategoria e asnjëanësit ka ardhur duke urdhur, por ndërsa tek emrat është në zhdukje e sipër, te mbiemrat e përemrat haset më dendur.

Ata emra, që në disa të folme të shqipes ruajnë ende formën e vjetër

1) Për karakterin sekundar të kësaj d-je shih: E. Çabej, "Grupet nd, ng në gjuhën shqipe" Buletin për Shkencat Shoqërore, IV, 1953, f. 32

të asnjëanësit, në këtë të folme tashmë janë bërë mashkullorë ose femërorë-p.sh. *djathi, mishi, mjalta, uji dhe ujt, vjami* etj. Vazhdojnë të jenë asnjëanës dhe të shquhen me nyjen -t dy emra: *kryet* dhe herë-herë *ujt* p.sh. *kryet e furks, kryet e shtelis, m'dhemb kryet, premja djalit kryet n'djep, ujt e lumit* etj., por kur lakohet emri *kryet* ndjek lakimin e emrave femërorë: *hapa kreje, kime kreje* etj.

Edhe duke i pasë bjerë karakteristikat formale të asnjëanësit, emrat e sipërpërmendur e të tjerë, kërkojnë që përemrat dëftorë të përdorur në vënd të tyre ose si përcaktorë, mbiemrat cilësorë të përdorur si kallëzues emërorë ose plotës predikativë të vihen në gjininë asnjëanëse. P. sh.

ata ô mish, ata ô mjalt, uj t'ftoft, ô ma t'ftoft ky, ô ma t'mir se ay, ô shtë t'bardh, djathi i dhive ô ma t'lik, ngat'her ardhkë t'mir, tlyen lope e delmje ô ma t'mir, ata tã'mlin | kur ja marrshin mazen | e nxã'nshin djath etj.

Analogjia e ka shtrirë këtë dukuri edhe në të tjerë emëra që nuk kanë qënë asnjëanës si *barut, buk, peksimet, tók* etj. p.sh. *ata baruti ish kapun me ata t'mbrendit | atere u ndezke fap kta t'jashit e e ndezke edhe ata t'mbrendit; nuk po hahet kta buk me krymba | nuk po hahet kta peksimet; këqyrr qada shtalb; ata h'ir e marrkë e e vndueke n'kus; kena dorzue tokën koprativs ata si ish pã sel edhe t'selunit* etj. Kemi pra në këtë mënyrë disa asnjëanësa sekundarë.

Mbiemra e pjesore të substantivuara në gjininë asnjëanëse nuk kemi ndeshur.

2. *Vrejte rreth gjinisë së disa emrave.* Në këtë të folme gjejmë disa emra që, në dallim nga shqipja letrare e sotmja, janë të gjinisë femërore p.sh. *t'u rrit ndera, pylla e fshatit, pyll e madhe, qiella, ullit e qiells, vjet e mir, tri vjet.*

Një numër emrash të tjerë kanë gjini të ndryshme në krahasim me gjuhën letrare ose edhe me të folme të tjera të veriut, p.sh. *ajk-u* (yndyra e leshit kur lahet, khs. *ajkë*), *šarap-i* (çarape-ja), *ed-edja* (et-i, ed-i, Mjeda: e kur t'zitë edi nder proje p. . .), *felqi-a* (fulqi-ni), *kollë bardh* (kolla), *kreja e korits* (ajka që zë qumështi i hedhur nëpër korita, khs. kreu, kryet), *manxerja* (manzer-i), *mendi em* (mendja), *persi* (perçja), *porceka* (porcek-u), *tav prej remet* (rrem-i), *vrri-ni* (verri-a).

3. *Shumësi i emrave mashkullorë.* Shumica e emrave mashkullorë në këtë të folme e formojnë shumësin me mbaresën -a p.sh. *berra, gajtã'na, kamisha, kërcuna, kùja, tre lshima, mã'nda, nipa, nxã'nsa, patërzona, pikša, pjafa t'lesht, qira, sheja, shiljera, shjartha, grun, pã therca, veshta, viša, vllaša, zgoja bjesh, zhguna, žamedona* etj.

Mjaft e shpeshtë është edhe mbaresa -e, p.sh. *djepet, fërkemet, kerret, maje, mure, vende, vorre* etj. Për emrat *berr* e *kùj*, veç shumësit me -a që u shënuan më lart, përdoret edhe shumësi me -e: *berre, kùje*.

Emrat, që në emëroren e pashquar dalin me -k, -g fundore, në numrin shumës, e palatalizojnë bashkëtingëlloren fundore. Për disa emra si *bujq, bunq, derq, fiq, mushq, ujq* etj. ky palatalizim është mjeti i vetëm për forcimin e shumësit. Shumë emra të tjerë veç kësaj marrin mbaresën -e dhe metafonizojnë zanoren e rrënjës p. sh. *brige, koniqe, leqe, pjeq, shti q, ose shtiqe, sardiqe, tforqe, tharqe* etj.

Emrat që në emëroren e pashquar dalin me dyzanorin -ue si *ftue, krue* etj. e formojnë shumësin me mbaresën -j (< -nj), e cila ka dalë si rezultat i palatalizimit të hundores -n të temës nga mbaresa e vjetër e shumësit -i: *fton+i>ftonj>ftoj*, po kështu *krue: kroj, prrue : prroj thue, : thoj* etj. për analogji më ta edhe *potkue: potkoj*. Emri *prue* meir në shumës mbaresën -e *prroje*, ose -na *projna*.

Emrat, tema e të cilëve mbaron me bashkëtingëlloren *-ll*, e formojnë shumësin duke e palatalizuar këtë bashkëtingëllore në *-j*. P.sh. *dyelli* : *dejt*, *fyell* : *fej*, *krapuell-krapoj*, *truell* : *troje*; *ençull* : *ençuj*, *hamall* : *hamaj*, *kungull* : *kunguj*, *mashkull* : *mashkuj*, *shekull* : *shekuj* etj., por *shjuell-shjolllet*. Edhe emri *lepur* e formon shumësin duke u zbutur *-r* në *j* *lepur*: *lepuj*.

Si pasojë e rënies së zanores *-ë* fundore, emrat që e kanë pasur këtë tingull si mbaresë të shumësit, sot e kanë shumësin njëlloj me njëjës, p.sh.: *dollap*, *dhamb*, *gür*, *katundar*, *klÿsh*, *dy pshjtjellak*, *shek*, *shok* etj.

Mbaresa e shumësit të llojrave *-na ujna*, *barna* etj. është shtrirë edhe në disa emra të tjerë si *krojna*, *lumna*, *projna* etj.

Emërat *frat* e *prift* në shumës marrin mbaresën *-ën* ndërsa i pari metafonizon edhe zanoren e temës: *fretën*, *priftën*.

Për emrin *djal* përdoren dy forma të shumësit *djelm* dhe *djel* (*kta ja^on djel t'mi*). Emri *käl* në shumës bën *kuallt*. Emërat *ka-kaq* dhe *shka-shkaq* e kanë shumësin përkatësisht *kije*, *shkije*, d.m.th. ka ndodhur metafonizimi i zanores së rrenjës *a:e* edhe pastaj diftongimi i saj *e:ie*. Emri *drapën* e formon shumësin me mbaresën *-i* e cila ka marrë mbi vete dhe theksin e fjalës: *drapni*. Emri *gardh* e formon shumësin me anë të mbaresës *-ije* e cila ka marrë mbi vete dhe theksin e fjalës: *gardhije*. Shumësi i emërit *brî-brîni* është *briëna*; shumësi i emrit *shat* është *shyëtën*; shumësi i emrit *krye* është *kren*: emri *çlla* e bën shumësin herë *çllazën* herë *çllezën*.

4. *Shumësi i emrave femërorë*. Shumica e emrave femërorë e formojnë shumësin me mbaresën *-a*. E marrin këtë mbaresë:

a) emërat që në emëroren e pashquar mbarojnë me *-ël*, *ëll*, *-ën*, *-ër* p.sh. *hudër-hudra*, *kërdhokëll-kërdhoklla*, *lakën-lakna*, *mokën-mokna*, *pendël-pendla*, *setër-setra*, *thundër-thundra* etj.

b) shumica e emrave që në emëroren e pashquar kanë pasë dalë me *-ë* fundore p.sh. *copa*, *dardha*, *flâ^onxa*, *gurra*, *tâ^ona herat*, *kërtolla*, *kmisha*, *pkuca*, *mshtjera*, *molla*, *pralla*, *rrepa*, *rruga*, *sakica*, *vajanica*, *vozga* etj.

c) emrat konkretë që në emëroren e pashquar mbarojnë me *-i* të theksuar: *frengija*, *kacija*, *kaçërdhija*, *kutija*, *shpija* etj.

Shumë emra nuk marrin ndonjë mbaresë në shumës. Këta janë:

a) emrat abstraktë që në emëroren e pashquar mbarojnë me *i* të theksuar si *šudi*, *mahi*, *trimni* (*po i lām trimnit* | *po marrim mahit*), *parti*, *çllazni* etj.

b) emrat, të cilët në njëjës e pashquar mbarojnë me *-e* fundore të pakte si *çyskoshiqe*, *perde*, *rrgalle*, *rrobe*, *toje* etj., poashtu *ni voe* — *shum çoe*.

c) emrat që kanë pasë mbaruar me *-ë*, p.sh. *bështajt*, *bjeshkt*, *fjett e bims*, *këp* (qepë) *kungt e shpÿs*, *katër vet* etj.

5. *Formimi i trajtës së shquar të emrave mashkullorë*. Emrat e gjinisë mashkullore paraqesin këto veçori në formimin e trajtës së shquar.

a) emrat që në emëroren e pashquar dalin me *-ën*, e *-ër*, kur shquhen e bjerrin zanoren *ë* : *ahër* — *ahri*, *emën* — *emni*, *tymën* — *tymni* etj, për arsye se ajo mbetet në rrokje të hapët.

b) emrat që në emëroren e pashquar dalin me dyzanorin *-ue*, kur shquhen rinxjerrin zanoren *o* të pazbërthyer dhe bashkëtingëlloren *-n* që dikur mbyllte rrokjen fundore : *krue* — *kroni*, *prue* — *proni*, *thue* — *thoni* etj.

c) emrat që në emëroren e pashquar dalin me *-uell* ose *-uer*, kur shquhen rinxjerrin zanoren *o* të pazbërthyer: *krapuell-krapolli*, *laknuer-laknori*, *puntuer-puntori*, *çershuer-çershori*, *shjuell-shjollli*, *truell-trollli*.

Po kështu edhe : *muej-moji*

c) emrat që sot mbarojnë me një zanore hundore duke pasë bjerë -n fundore, në trajtën e shquar e rinxjerrin këtë bashkëtingëllore. Po kështu e formojnë trajtën e shquar edhe disa emra të tjerë që sonoren -n dhe nazalizmin i kanë për analogji me emrat e sipërpërmendur. Shëmbuj : *bli-ni, brî-ni, drê-ni, Drî-ni, drû-ni, drÿ-ni, frê-ni, gû-ni, gî-ni, hû-ni, kërcû-ni, mullî-ni, pè-ni, sÿ-ni, trû-ni* etj.

d) emrat që mbarojnë me bashkëtingëlloren -h shquhen me nyjen -i, kurse ata që mbarojnë me -k e -g shquhen me nyjen -u. P.sh. *ah-i, krah-i, tezÿah-i, sabah-i, ; bûng-u, breg-u, lâng-u, prag-u, ; ajk-u, bulk-u, dushk-u, ñak-u, lak-u, mushk-u, pshjtjellak-u, qerpik-u, shpijak-u, tÿfurk-u, uk-u* etj.

dh) emrat që mbarojnë me një zanore të theksuar -a, -é, i e formojnë trajtën e shquar me anë të nyjes -u e cila realizohet si gjysëm zanore -u. P.sh. *dheÿ, kaÿ, shkaÿ, vllaÿ, thiÿ* etj.

e) emrat turko-arabë të personave, kur mbarojnë me -i të theksuar, shquhen me anë të nyjes së prapme -a, duke marrë para saj dhe një -j- antihiatizuese: *Alija, Avdija, Hakiya, Hysniya, Murec Sadrija* etj.

6. *Kallëzorja e shquar* e emrave mashkullorë që mbarojnë me zanore të theksuar formohet duke i prapangjitur temës pandërmjetësisht nyjen e prapme -n, p.sh. *e muer fjala dhën; e muer miza kân; s'e kâ'm vllân tu shpija; a e pave Hakin?* etj.

7. *Gjindorja e dhanorja shumë.* Shumica e emrave që në numrin shumë dalin me temë në bashkëtingëllore në këto dy rasa nuk kanë -v- epentetike midis temës e mbaresës rasore -e. P. sh. *lumi i Çonpepaje, i Lekbajet, sonau miqet falmeshndet, i pari i Mulaje e Nikaje, kallauzi i Nikaje, shpija robet, ja u dake robet, ka dymbdhet gajdâ'na ja u qitke tirqet për gû, kundra turqet, me u thâ'n vllaznet, u thot vllaznet Markut, me ndihmën e v'llaznet, m'u ba t'fala tâ'n vllaznet* etj., por edhe *m'Therme t'Nikajve, ja u dorzueshin krushÿve, shokve.*

Emrat që sot në numrin shumë dalin me temë në bashkëtingëllore për shkak të rënies së mbaresës -ë marrin rregullisht -v- epentetike: *për mos me i ra fjetvet, krahvvet* etj.

8. *E ashtuquajtura "vendore".* Në këtë të folme ndihet mjaft edhe e ashtuquajtura "vendore". Kjo formë rasore shoqërohet kryesisht nga parafjalët *m'e n' (nd')* që tregojnë vënd, por s'mungojnë shembëlla edhe me parafjalën me që tregon shoqërim ose mënyrë. P.sh. *m'njâ'nt ân u dake tlyeni | m'njâ'nt ân u dake musënica; m'njâ'nt ân i dake indin | n'tjetrët ân tymnin; me hîp m'shalt; m'u ora ai shoqî m'skajt* etj.; *n'nadjet; n'pramjet; mos t'bjen ñâ'ja n'llošt; e shtin n'Krum n'dhet; n'ÿshkut sob; i mbrehke n'majet; e shtishim n'dhet; nd'ahrit kulls; ja shtishin kâ' n'rrâ'jt; ja shtike n'grykt; e ki pa mârr zhÿeta n'ashtit* etj.; *mbasi hâ'ngshin bûk | dalshin me u nis me nuset; erdha dÿ dit me ndëj me djalt; me mârr me zorrt* etj.

9. Emrat e gjinisë femërore përveç rrjedhore së shquar me nyjen e prapme -s (*prej ars seme; duel fush; rrugs; rreth tërvezs* etj.) kanë edhe një tjetër, trajtë të ndërtuar nga rrjedhorja e pashquar plus nyjen -t: *lesh delmjet, a je la ftyret, para kohet, var pushket, qoshe shpijet* etj., e cila, siç shihet dhe nga shëmbujt, nuk ka kuptimin e trajtës së shquar. Nyja -t e kësaj trajte ka dalë nga analogjia me rrjedhoren e emrave mashkullorë.

10. *Nyja.* Në një tog fjalësh të përbërë prej një emri në rasën emërore të shquar dhe një emri tjetër në rasën gjindore nyjet e përparme i dhe e dëgjohen mirë. P.sh. *baba i djalit, bishiti i siftelis, djathi i dhive, helli i ferligut, kali i siftelis, koshi i mullinit, lângu i djathit, podi i shpis, rrypi i për-mjetit* etj.; *bija e filanit, Korja e Mërturit, Kulla e Thepit, nata e buzmit, qafa e shtjerrave, thika e buks, vatha e ñave, vija e ujit* etj.

Mbiemrat e nyjshëm të gjinisë mashkullore pas një emri në rasën emërore të shquar dalin si të panyjshëm: *harapi zi, kolli bardh, kolli keq* etj. kurse mbiemrat femërorë në po këto rrethana e kanë nyjen e përparme e: *pramja e m̄r, udha e mb̄r* etj.

11. *Përemrat vetorë*. Përemri vetor i vetës së parë njëjës ka rregullisht trajtën e thjeshtë ù: ù *ishna tuj punue, kto arra ù i kam vndue, ù e pava ù i s' e pay* etj. Trajtën un ta zë veshi ndonjëherë nga rinia. Trajta e shumësit është na: *po vim dhe na atje, na i kena n̄s pushkën* etj., por në një këngë kemi shënuar: *Ali Haka ka ne ka shkue*. Trajta e dhanores e e kallzores është nē: *nē na ka thā°n, nē na ka git* etj. Trajtën neve e kemi ndeshur një herë të vetme në një këngë: *u bā° me neve Geghyseni*, të përdorur me funksionin e kallzores.

Për vetën e tretë njëjës të gjinisë mashkullore përdoren dy trajta: *ai* dhe *ay*. Kjo ndodh edhe kur këto dy fjalë përdoren si përemra dëftorë. P.sh. *po lifton ai, mbas njaj thepi; s'mun i zapueke ai; s'deshkë ai me ardh; ka shkue ai e ka dāl n'Curraj* etj.; *ay ôsht hi ktu e ka shtrua zollumin; ay t'presin; iku ay prej çakovet; t'ish kâ°n ay* etj. Trajta e rasës kallzore është atō, ndërsa kur përdoret me parafjalë tō: *a e pave atō? fola me tō, ô rahatue me tō, e vokshim sa t'durosh gishtin pak n'tō, kurrfar ndërtese s'ô kâ°n* etj.

Trajta e shkurtër e dhanores së vetës së dytë shumës është *u: hoshgelden u koft, s'u lshojm, u ndiesha t'mirën* etj. Edhe për dhanoren e vetës së III-të shumës trajta e shkurtër është u, por ndonjëherë përdoret ju që e bashkuar me trajtën e shkurtër e jep ja u: *nē shp̄i robet me ja u sue, ja u ka marr* etj. Ndonjëherë ndodh edhe sinalefa e trajtës së shkurtër: *kena nis pushken mos me lā°n me hi ktu*.

12. *Përemrat dëftorë*. Për sende e frymorë që ndodhen pranë folësit përdoren përemrat *ky, kjo*. Rasa gjindore-dhanore e përemrit *ky* është *kt̄i: kt̄i burrit, kt̄i mikut* etj., rasa kallëzore për të dyja gjinitë është *kēt: kēt cucën, kēt katuud, kēt lajm, kēt s̄ikën*. Rrjedhorja shumës për gjininë mashkullore është *ksi: ksi burrash, ksi trimash* etj. për gjininë femërore *kso: kso fjalsh, kso grash* etj. Trajtat *ksi* e *kso* nuk kanë thjesht kuptim dëftor, ato më fort tregojnë cilësi dhe kanë kuptimin e përemrit tjetër dëftor *i tillë*.

Për objektë e frymorë që ndodhen larg folësit përdoren *ai* e *ay* për gjininë mashkullore dhe *ajo* për gjininë femërore. P.sh. *ai a ky? ai e ka emnin e gāt; ish kâ°n martue ai sakat; por qysh bā°n i mjeri ai Çerg Eleja; ay si ôsht mir; ô mō t'm̄r se ay* etj. Rasa gjindore-dhanore e përemrave *ai* e *ay* është *at̄i*; rasa rrjedhore është *asi: asi vakti*, për gjininë femërore *aso: aso here* etj.

Por në shumicën e rasteve përemrat dëftorë marrin si një element të dytë deiktik pjesëzën *qe*, e cila na e dallon edhe më mirë sendin a frymorin që dëftojmë. P.sh. *m'qet korriz i kâ°m pās tridhet e shtat kile; m'qat pūn ja kâ°n ngit emnat qashtu; me qat zanat merret; me qet parti jena mirsue boll; t'i kisha treqind vllazën si qeda; me qasosh kan listue ata; me qasosh kaluem na; vjet e kena mbjell qeta; ama qada shtalb; qado vende me i zaptue; qada si erdhën te na* etj.

13. *Përemrat Pronorë*. Përemrat pronorë të vetës së parë e të dytë (prona e pronari njëjës) kanë nyje të përparme: *i jemi, e jemja; i yti, e jotja*. Kur përdoren si mbiemra pronorë nyja e përparme herë çlaqet e herë mungon: *plugu i jem, parmenda e jeme, por djali jem, sika jeme; mā°ndi i yt, pelā e jote, por djali yt, sika jote*.

Në numrin shumë përmrat pronorë të këtyre dy vetave nuk kanë nyje të përparme: *i kuj ô ky kâl? yni; e kuj ô kjo ar? jona: jueji, jueja; edhe kur përdoren si mbiemra zakonisht janë pa nyje: kali yn, katundi yn, pela jon; djali juej, shika juej* etj., por *mândi i yn*. Mbiemrat pronorë të vetës së dytë (pronari njëjës, prona shumë) nuk kanë nyje të përparme: *djelt tu, shikat tua* kurse përmrat pronorë janë me nyje të përparme: *jâ^on t' tui, jâ^on t' tuat*. Në vetën e dytë (pronari shumë, prona shumë dhe e gjinisë mashkullore) përdoret trajta e vjetër *taj: djelt taj, sjept taj*, kur prona është e gjinisë femërore kemi: *shikat tueja, shpijat tueja*.

Tabelë përmbledhëse

Pronari	Prona	Veta e I-rë		Veta e II-të	
		M	F	M	F
Njëjës	Njëjës	i jemi djali jem plugu i jem	e jemja shika jeme pamenda e jeme	i yti djali yt mâondi i yt	e jotja shika jote shika e jote
	Shumës	t' m̄ t djelt e m̄	t' mijat shikat e mija	t' t̄ut djelt tu	t' tuat shikat tua
Shumës	Njëjës	yni kali yn mâondi i yn	jona pela jon	jueji djali juej	jueja shika juej
	Shumës	t̄ant djelt t̄an	tonat shikat tona	djelt taj	shikat tueja

Në këtë të folme përdoret gjerësisht edhe përmri pronorë vetvetor *i, e vet*, p.sh. *katundin e vet; martoj shikn e vet; me asqerin e vet; me e pās shik t' vën; n' shpi t' vet; nanës vet; për atdhe t' vet* etj.

Emri i përcaktuar nga një mbiemër pronorë përdoret shpesh edhe në trajtën e pashquar: *n' shiljer temin, është pun e jemja, është tok e jemja, është pun e jotja* etj. Në këtë rast mbiemri pronorë vihet në trajtë të shquar.

14. Përmri lidhor. Përmri lidhor i pandryshueshmi në këtë të folme është *si*. P.sh.: *ai si fjaturon; atyne si kâ^on pulat; ata si sillen; baba i djalit si kâ vajza; edhe ato si kâ^on gâk / edhe ato si s' kâ^on gâk; jâ^on dek ata si dishin; trim i thoshin atij si lifto për atdhe t' vet* etj. Në raste të rralla që duket se janë ndikime të shtypit, shkollës etj. kemi dëgjuar edhe përmrin *qi*, p.sh. *na u hap lajmi m' katër an / për raketën qi shkoj n' hâ^on, për këtë lajm qi ju dha njerzimit* etj.

15. Përmrat e pakufishëm. Përmri i pakufishëm *gi(th)* i përdorur me parafjalën për ka kuptimin "çdo", p.sh.: *për gi nat* (për çdo natë), *për gi dit* (për çdo ditë), *për gi th vjet* (për çdo vit) etj.

Përmrat e pakufishëm kompozita me fjalën *kurr* si element të parë, kur përdoren në fjali pyetëse nuk kanë kuptim mohor p.sh.: *a mûn na e*

bâ°ni kurrfar ndime? a din me na kallzue Mark kurnnjô? (është fjala për të treguar ndonjë përrallë) etj.

16. *Numërorët*. Numërori *një* në këtë të folme del në variantin fonetik *njô*: *sa djel kie? kâ°m njô; ka i kem kta mashku? njô pej Bashkimit, njô pej Çekasllovakie* . . . Në këtë trajtë fonetike ky numëror hyn edhe në përbërjen e disa përmrave të pakufishëm si *asnjô, kurnnjô*. Në bashkëvajtje me emra dhe si nyje e trajtës së pashquar përdoren *ni* dhe *i (î)*. Nga këto fjala *ni* është më shpesh mbiemër numëror dhe *i* nyje e trajtës së pashquar. Kur është pas një fjale që sos me zanore, *i*-ja bëhet gjysëmzanore *i*. Po rendisim një varg shembujsh më parë për *ni* e pastaj për *i (î)*: *e psh tolla ni cigare; i dhimkie ni kamb; mbas ni kershî tuj listue; me i qit edhe ni fije tâ°mël | del t'mir; ni maçup kish pa ârdh e murr sikën; ni pllomb e ni pëlshik; ni sik e vogël n'djep | i ka hâ°ngër thi uesht; por ni baloz prej detit ôsht dâl etj.: bâ°na i konak t'mîr; hajt i hër; i dit prej ditsh, i gastare rakî; i pend kije; ka i nîer i për shpî, kem lâ°n luftën sot i jâv, tu i kopsht etj.*

Në të përdorurit e *ni* ose *i (î)* shpesh vendosin dhe arësye thjesht metrike, siç mund të shihet në tri vargjet e mëposhtëme:

ka î dasht n'dit e lyp me ja pjek |
ka î sjap n'dit e lyp me ja rjep |
ka ni shik me tô me fjet ||

F o l j a

1. *Foljet kam e jam*. Këto dy folje në të tanishmen e në të pakryerën e mënyrës dëftore kanë një larmi trajtash.

Folja jam

E tanishmja: njëjës v. I *jâ°m*, v. II *jê*, v. III *ôsht, ô*; shumës v. I *jena, jem(i)*, v. II *ini, jini*, v. III *jâ°n*.

Si në mbarë gegërishten edhe në këtë të folme për vetën e tretë njëjës përdoren paralelisht dy forma *ôsht* dhe *ô*. Nuk mund të caktohet një rregull se kur përdoret njera e kur tjetra. Trajta *jem* e v. I shumës përdoret vetëm si ndihmëtare: *jem râ n'Tirâ°n, jem trêt, jem ka e hjekim, jemi përgadit etj.*, kurse *jena* përdoret edhe me kuptim të pavarur edhe si ndihmëtare: *ktu jena; jena afrue, jena dâl, jena shef atyne projeve, jena shkue etj.*

E pa kryera: njëjës v. I *ishna, jeshte*, v. II *ishne*, v. III *ish* shumës v. I *ishim, im*, v. II *ishî (t)*, v. III *ishin, in*. Nga trajtat *ishna* e *jeshte* të vetës së parë ajo që dëgjohet më shpeshë është *ishna*, kurse *jeshte* përdoret rrallë: *û jeshte ushtar, t'jeshte kâ°n û, û jeshte kâ shkoi*. Trajta e sinkopuar *im* e v. I shumës përdoret shumë më dendur së *ishim*: *ishim n'Bris na; nan tô ishim, por im gati i qind vet, im pa hâ°ngër kur i grim, im dâl me dëk me tâ° etj.* Po kjo mund të thuhet edhe për trajtat *ishin* e *in* të v. III: *in aty, in kâ°n dëk fmi unit, in fyshek letret, nimij vet in kâ°n, qada in ka i bashkojn* (ata po i bashkonin) etj.

E kryera e thjeshtë është: njëjës v. I *kesh*, v. II, III *ke*, shumës v. I *këm*, v. II *kêt*, v. III *kën*.

Për të formuar trajtat kohore analitike të foljes *jam* në këtë të folme si ndihmëtare shërben ajo vetë: *jâ°m kâ°n, je kâ°n, ô kâ°n, jam kâ°n, ini kâ°n, jan kâ°n; ishna kâ°n | t'jeshte kâ°n, ishniê kâ°n, ish kâ°n, ishim kâ°n, ishit kâ°n, ishin kâ°n*.

Folja kam

E tanishmja: njëjës v. I *kâ^om*, *kô*, *kû¹*), v. II *kie*, v. III *ka*; shumës: v. I *kena*, *kina*, *kem*, *kemi*, v. II *keni*, *kinî*, v. III *kân*. Trajtat e apokopuara *kô* e *kû* të vetës së parë përdoren vetëm si ndihmëtare: *e kô bjue*, *e kô pã vet*, *e kû pjeqnuë*, *e kû pãs vllãn meta* etj.; kurse trajta *kâ^om* përdoret edhe me kuptim të pavarur edhe si ndihmëtare: *û kâ^om tri shika*, *û kâ^om ni mushk*, *e kâ^om pãs*, *e kâ^om bje* (ble) etj. Në trajtën *kie* të v. II ka ndodhur diftongimi i zanores e që ka qenë e gjatë: *kẽ > kie*. Në vetën e II-të njëjës të habitores dhe në vetën e tretë njëjës të së pakryerës, ku kjo zanore ka mbetur e pa-thekse, diftongimi nuk është bërë, por gjatësia është ruajtur: (ti) *paskẽ* (ai) *ardhkẽ*, *punuekẽ*, *shkuekẽ* etj. Trajta *kem* e v. I shumës përdoret zakonisht kur folja shërben si ndihmëtare: *kem listue*, *kẽm ndẽj*, *kem sël token torokop*, *kem vulos* etj., kurse trajta *kena* përdoret edhe me kuptim të pavarur edhe si ndihmëtare: *vështa nuk kena*, *puntõr kena pak*, *i kena gũe*, *e kena mbjell*, *i kena nĩs*, *e kena pãs*, *i kena qit* etj. Trajtat *kina*, *kemi*, janë mjaft të rralla: *ktu i kina*, *fiq nu kemi*, *s'e kemi lã^on me e djẽg Brisën*, *e kemi listue*.

E pakryera: njëjës v. I *kishna*, *kishte* v. II *kishne*, v. III *kish*, *ki*; shumës v. I *kishim*, *kim*, v. II *kishit*, v. III *kishin*, *kin*. Ashtu si folja *jam* edhe *kam* në vetën e parë njëjës të së pakryerës ka dy trajta *kishna* e *kishte*, prej të cilave e dyta është mjaft e rrallë. Trajta *ki* e v. III përdoret vetëm si ndihmëtare; *Zogu i ki bje me pare*, *tu qã i krue ki ngrë sãdrat*, *ki pãs*, *ki shkue*, kurse *kish* përdoret më fort kur folja ka kuptim të pavarur: *kish zakon u mbledhke populli*; *e kish veshin sa i zhgun burrit* etj. Trajta *kishim* e v. I shumës përdoret mjaft rrallë; zakonisht përdoret trajta e sinkopuar *kim*; *jetesn e kim t'zorshme* *l se nuk ish kurrfar vegle*; *nuk kim alet t'mir*; *kim pushk pak*. Po ashtu edhe për v. III, zakonisht përdoret *kin*: *kin fuqi t'madhe ata*; *ata kin fyshek boll*, *i kin pa qit para* ndërsa *kishin* është e rrallë: *nu kishin bũk*.

Diateza Veprore

Mënyra Dëftore

1. E Tanishmja

Zgjedhimi i parë²). Veta e parë e njëjësit pothuajse rregullisht del me mbaresën *-i*, p.sh. *dhezi*, *eci*, *foli*, *korri*, *lidhi*, *lypi*, *mbjelli*, *nãjerri*, *pshtjelli*, *shkuli*, *vjeli*, *zhdripi* etj. Veta e dytë dhe e tretë nuk kanë mbaresë: (ti, ai) *dhez*, *ec*, *fol*, *kor*, *lidh*, *mbjell*, *shkul*, etj. Mbaresat e shumësit janë: v. I *-im* *dhezim*, *ecim*, *folim*, *korrim*; v. II *-ni* *dhezni*, *ecni*, *folni*, *korri*; v. III *-in* *dhezim*, *ecin*, *folin*, *korrim*.

Foljet që e metafonizojnë zanoren *-a-* të temës, në vetën e parë nuk kanë mbaresë: (unë) *dal*, (ti, ai) *del*; (unë) *marr*, (ti, ai) *merr*; (unë) *narth*, (ti, ai) *nerth* "mërdhij" etj.

Kur tema e foljes del më një bashkëtingëllore grykore (*-g*, *-k*) në vend të mbaresave vetore *-i*, *-im*, *-in* përdoren *-u*, *-um*, *-un*, p.sh. *po iku*, *po ndjeku*; *i lagum*, *po ikum*, *p'e ndjekum*, *pjekum*, *djegum*; *ikum*, *lagun*, *ndjekun* etj.

1) Siç na kumton prof. E. Çabej këtë formë e ka edhe Dibra.

2) Për klasifikimin e foljeve në zgjedhime jemi bazuar te Gramatika e Gjuhës Shqipe e K. Cipos. Tiranë, 1949.

Zgjedhimi i dytë. Foljet e klasës së parë kanë në v. I mbaresën *-i*, në v. II e të III nuk kanë ndonjë mbaresë dhe në shumës marrin mbaresat v. I *-im*, v. II *-ni*, v. III *-in*. P.sh. (unë) *mbyti, goditi, llomiti, prashiti, vaditi* etj.; (ti, ai) *mbyt, godit, llomit, prashit*, etj.; shumësi: v. I *mbytim, goditim, llomitim* etj.; v. II *mbytni, goditni, llomitni* etj.; v. III *mbytin, goditin, llomitin* etj.

Foljet me *-es, -as* në vetën e parë dalin me temë më *-s* dhe pa mbaresë, në vetën e dytë e të tretë me temë më *-t* dhe gjithashtu pa mbaresë, në numrin shumës me temë më *-s* (në v. II shumica e foljeve dalin edhe më *-t*) dhe me mbaresat *-im, -ni, -in*. P.sh. (unë) *jes, pres, qes, shqas, vras*, etj.; (ti, ai) *jet, pret, qet, shqet, vret*, etj. Shumësi v. I *jesim, presim, qesim, shqasim, vrasim* etj.; v. II *jisni / jitni, prisni / pritni, qisni / qitni, shqisni / shqitni, vritni* etj.

Zgjedhimi i tretë. Veta e parë njëjës ka mbaresën *-j* punoj, shkoj, thyej etj. Në vetën e dytë e të tretë bie shpesh herë mbaresa *-n*, p.sh. *as Shala s'pat sha i bā°; m' bā° zollum me pī; e merr / e korr / e bā° grumbull / e mat sa po gē; me kā°n dhija e smund / edhe edhe lē i smund; vjen e rritet e hī nd'ara [lumi]; ai t' kallxo historina për kur t' e pvetish; s'un po na kallxo, po listo ai; a kupto? si po shko?; nuk e ndrō guhën deri t' desin; ai si po lye; blu e shkōn te shpija* etj. Me sa dimë kjo nuk është një çfaqje e zakonshme për të folmet e gegërishtes veriore.

Format e shumësit nuk paraqesin ndonjë veçori dialektore. Folja "me fjetë" në këtë të folme ka kaluar në zgjedhimin e tretë: 1) *fjej*, 2) *fjen*, 3) *fjen*; 1) *fjejm*, 2) *fjeni*, 3) *fjejn*. Kështu zgjedhohen edhe foljet *bie* (në të dyja kuptimet: *bie-rashë, bie-prura*) e *shtie*. Në vetën e dytë e të tretë të njëjësit theksi ka kaluar nga zanorja *i* mbizanoren *-e* duke shkaktuar jotizimin e *-i-së*: 1) *bie*, 2) *bje(n)*, 3) *bje(n)*; 1) *biem*, 2) *bini*, 3) *bien*; 1) *shtie*, 2) *shtje(n)*, 3) *shtje(n)*; 1) *shtiem*, 2) *shtini*, 3) *shtien*.

Zgjedhimi i katërt. Foljet e zgjedhimit të katërt dhe disa folje të parregullta e supletive marrin shpesh herë në v. II e të III të njëjësit mbaresën *-n*: (ti, ai) *don, rrin, han* etj., kurse te (ti, ai) *eje* mbaresa *-n* ka rënë. Folja *vete* në këtë të folme ruan trajtën e vjetër monosilabike *ve*: *ka je kā ve* (ku po vete)?

2. *E pakryera.* Trajtat e së pakryerës në këtë të folme formohen nga tema e pjesores me anë të këtyre mbaresave vetore: njëjësi v. I *-shna*, v. II *-shne*, v. III *-ke*, shumësi v. I *-shim*, v. II *-shit*, v. III *-shin*. Shihe qartë se këto mbaresa, me përjashtim të vetës së tretë njëjës, janë trajta, e së pakryerës të foljes *jam* pa zanoren *-i* nistore.

Shembuj :

v. I *dalshna, kapshna, i marrshna pare, punueshna, shkueshna, shkullshna* etj.

v. II *kapshne, punueshne, shkueshne, shkullshne* etj.

v. III *Tirā°na ardhkē e marrkē harz n' Shkodër e e s̄uekē n' Tira°n, bā°kē lopa tridhet grosh; nuk ditkē baba jem me u marr vesh me kta; s'guzuekē kush me dāl fushēs; e prukē me kerr; e marrkē e e v̄nduekē n' kus̄; frati kur t' pjaket / e m̄bakē Kuvendi; s'u pvetkē djali as šika; për dy tri fjal t' rakē pushk; e vluekē nja i gys sahati; s'mun i zapuekē* etj.

Kjo është e vetmja trajtë e vetës së tretë të së pakryesës për këtë të folme dhe, ndonse nga ndërtimi duket si një habitore, nuk ka kurrfarë ngjyrë habije, siç ndodh p.sh. në të folmen e Oparit¹⁾.

1) J. Gjinari "Një vështrim mbi të folmet e Oparit" Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore, 1, 1957, f. 148.

Shumësi.

V. I *bjeshim* (blejshim); *jetueshim*; *lishim*; *liftueshim* etj.

V. II *delshit*, *gëtshtit*, *kapshit*, *mjelshit*, *shkueshit*, *shkulshit*, *punueshit*, *th^onshit* etj.

V. III *dalshin*, *dishin*, *pagueshin*, *i prushin rakⁱ* / *i prushin mish*; *h^ongshin cⁱll*, *sosshin*, *shkueshin mbetshin tuj pi rakⁱ* etj.

3. E kryera e thjeshtë

Zgjedhimi i parë. Klasa e parë. Foljet e kësaj klase e kanë temën e së kryerës së thjeshtë njëloj me të së tanishmes dhe marrin këto mbaresa: njëjësi v. I -a, v. II -e, v. III -i(u).; shumësi v. I -em, v. II -et, v. III -en.. Mbaresa -u e vetës së tretë njëjës përdoret kur tema e foljes del më g ose k (ai) *lagu*, *hjeku*, ndërsa kur del me -h përdoret mbaresa -i: (ai) *grahi*. Folja *me djëg*, te e cila bashkëtingëllorja g palatalizohet në ğ, në vetën e tretë nuk ka mbaresë: (ai) *doğ*. Shembuj: *dheza*, *dheze*, *dhezi*, *dhezëm*, *dhezit*, *dhezën*; *zhdripa*, *zhdripe*, *zhdripi*, *zhdripëm*, *zhdript*, *zhdripën*.

Klasa e dytë. Në foljet e kësaj klase ndodh apofonia e zanoreve a, e dhe e grupit *je* në o. Kjo në veten e tretë të njëjësit dhe në tërë shumësin del e diftonguar në ue, duke qenë se është ndodhur në rrokje të mbyllur. Veta e tretë e njëjësit nuk ka mbaresë. Vetat e tjera marrin mbaresat që u përmendën për klasën e parë.

Shembuj: *dola*, *dole*, *duel*, *duelëm*, *duelt*, *duelën*; *mola*, *mole*, *muel*, *muelëm*, *muelët*, *muelën*; *mbolla*, *mbolle*, *mbuell*, *mbuellëm*, *mbuellt*, *mbuellën*, *pshtolla*, *pshtolle*, *pshtuell*, *pshtuellëm*, *pshtuellt*, *pshtuellën*.

Zgjedhimi i dytë. Shumica e foljeve të zgjedhimit të dytë në të kryerën e thjeshtë dalin me temë më -t dhe marrin mbaresat vetore -a, -e, -i, *ëm*, -t, -ën. P.sh. *prashita*, *prashite*, *prashiti*, *prashitëm*, *prashitt*, *prashitën*; *prita*, *prite*, *priti*, *pritëm*, *pritt*, *pritën*; *vadita*, *vadite*, *vaditi*, *vaditëm*, *vaditt*, *vaditën* etj.

Foljet *pres* (me pre) dhe *oras*, tema e të cilave del me zanore, në vetën e parë e të dytë të njëjësit marrin një -o- antihiatizuese, në vetën e tretë marrin mbaresën -u e cila realizohet si gjysëmzanore (u); mbaresat e shumësit janë -m, -t-, -n. P.sh. *preva*, *preve*, *preu*, *prem*, *pret*, *pren*; *vrava*, *vrave*, *vrau*, *vram*, *vrat*, *vran*.

Zgjedhimi i tretë. Klasa e parë. Foljet e kësaj klase marrin mbaresat -a, -e, -i, -m, -t, -n: *b^ona*, *b^one*, *b^oni*, *b^om*, *b^ot*, *b^on*; *fr^ona*, *fr^one*, *fr^oni*, *fr^om*, *fr^ot*, *fr^on* etj.

Klasa e dytë. Në vetën e tretë njëjës vetëm foljet më -oj marrin mbaresën j, foljet më -aj, -ej dhe -uej marrin mbaresën (u), kurse foljet më -t nuk kanë mbaresë. Të gjitha foljet që kanë -o- në temë në të tria vetat e shumësit e zërthejnë në -ue-, kurse ato që kanë -e- e zërthejnë në -ye-. Shembuj: *fjeta*, *fjete*, *fjet*, *fjetëm*, *fjett*, *fjetën*; *ġeta*, *ġete*, *ġet*, *ġetëm*, *ġett*, *ġetën*; *kërkova*, *kërkove*, *kërkoj*, *kërkuem*, *kërkuet*, *kërkuen*; *shkova*, *shkove*, *shkoj*, *shkuem*, *shkuet*, *shkuen*; *leva*, *leve*, *leu*, *lyem*, *lyet*, *lyen*; *theva*, *theve*, *theu*, *thyem*, *thyet*, *thyen*; *dava*, *dave*, *day*, *dām*, *dāt*, *dān*; *lava*, *lave*, *lau*, *lām*, *lāt*, *lān*; *leva*, *leve*, *leu*, *lēm*, *lēt*, *lēn*; *shkrova*, *shkrove*, *shkrou*, *shkruem*, *shkruet*, *shkruen*.

E kryera e thjeshtë e foljes supletive *me pa* është asigmatike dhe veta e tretë njëjës ka mbaresën -u: *pava*, *pave*, *pau*, *pām*, *pāt*, *pān*. E kryera e thjeshtë e foljes supletive *me ra* është sigmatike: *rash*, *rē*, *rā*, *rām*, *rāt*, *rān*.

4. *E kryera*. Foljet intranzitive që tregojnë lëvizje e formojnë të kryerën me anë të ndihmëtares *jam*. P.sh. *është ardh, jini ardh, jem ardh, o dāl drita, jem dāl, mileti jā^on hi maleve, jā^om hik, jā^on shkue, jā^on vot* etj.

Kur këto folje marrin një kundrinë të zhdrejtë, të kryerën e formojnë me anë të ndihmëtares *kam*: *i kena dāl para, i kena shkue te shpija* etj.

Përdoret dëndur edhe e kryera e dytë, ndërtuar nga e kryera e foljes ndihmëse dhe pjesorja e foljes themelore. Në këto raste pjesorja *pasë* del gjithmonë në formën e apokopuar pa p.sh. *kā^on pa bā^o; ka pa bāj^ot; mbreti i ka pa djēg; kā^on pa lshue boll; ka pa mār^or; e kā^om pa shti pa mbush moshën; kem pa jetue zor na; jā^on kā^on dāl von kto* etj.

5. *E kryera e plotë*. Edhe e kryera e plotë e foljeve intranzitive që tregojnë lëvizje formohet me anë të ndihmëtares *jam*: *ish ardh; ish ik* etj. Trajta e mirëfilltë e së kryerës së plotë në të folmen e Nikaj-Mërturit nuk para përdoret shumë. Në vend të saj përdoret e kryera e plotë e dytë, ndërtuar nga e kryera e plotë e foljes ndihmëse dhe pjesorja e foljes themelore. P.sh. *ish kā^on ārdh; kish pa bā^o t̄dhi me ja lā^on qat cop vend; kulla nuk kin pa bā^o atere; ish kā^on dāl me verue atje; in kā^on dēk fm̄ ūnit; ish kā^on mbet; ish kā^on shkue ushtar n' Stamboll; e ki pa marr zhēta n' ashtit; ishin kā^on vrā sa ndër veti* etj.

Rrallë përdoret edhe e kryera e tejskuar: *pata dāl; i pata šue plot i mushk me miell* etj.

6. *E ardhëshmjia*. Në këtë të folme përdoren dy forma të së ardhëshmes: *do + lidhore e foljes themelore dhe kam + paskajoren e foljes themelore*, p.sh. *ša do t' bā^ojn tash ai; do t' iku prej shpijet; poki do t' i randojnë edhe puna; kā^om hā^ongēr e jā^om ngi e do t' zhdripi m' tōk; do t' thom; kā^om me shkruie; kā^om me shkue; n'koft se shkaq̄ kndejnaj ka me dāl . . .; punën tā^onde kā^om me ja ū thā^on* etj.

7. *E tanishmjia e lidhore*. Në vetën e dytë njëjës foljet e zgjedhimit të parë e të dytë midis temës e mbaresës *-sh* kanë zakonisht zanoren *-i*: *t' dalish, t' ecish, t' ja falish, t' e pvetish*, por *t' apsh, t' marrsh*. Foljet e zgjedhimit të tretë dhe foljet e tjera me temë vokalike midis temës e mbaresës *-sh* marrin bashkëtingëlloren *-j*: *t' punojsh t' rrojsh, t' shkojsh, do t' thuejsh, do t' lyejsh* etj. Si zanorja i ashtu dhe bashkëtingëllorja *j* duket se janë një shtrirje e mbaresave të vetës së parë: unë *t' eci* — ti *t' ecish* — ti *t' punoj* — ti *t' punojsh*.

Veta e tretë njëjës del njësoj si veta e tretë shumës, dmth. për zgjedhimin e parë e të dytë me mbaresën *-in*, për zgjedhimin e tretë me mbaresën *-jn*: *vjet filloj t' apin prodhim për her t' pār; kur t' dalin ajo nusja q̄i t' vin aty nd' oborr, kur t' kryejn ēndin j bā^on kokēr; q̄ysh t' marrin moti, mos t' e thejn bora; t' rrojn Partia* etj.

8. *Urdhërorja*. Zanorja *e* e temës së disa foljeve të klasës së dytë të zgjedhimit të parë herë metafonizohet në *i* herë jo: *mos del, mos delni — dil; šele — šile*. Te foljet me temë vokalike ndodh edhe kontraksioni i zanoreve fundore *e* dhe *a* me trajtën e shkurtër *e* të përemrit vetor: *le + e = lē; ora + e = vrē*.

Veta e dytë shumës formohet me anë të mbaresës *-ni*: *leni, vrani* etj. Trajta e shkurtër *e* vihet gjithmonë pas kësaj mbarrese, p.sh. *lenie, prenie, šonie, vranie* etj. por del në pozicion proklitik kur para foljes ndodhet pjesëza e mohimit *mos*: *mos e leni; mos e vrani* etj.

9. *Pjesorja*. Përgjithësisht pjesorja në këtë të folme del pa ndonjë mbaresë.

Për zgjedhimin e parë e të dytë, me rënien e *ë*-së fundore, tema e pjesores del me bashkëtingëllore edhe kur kjo është një likuide. Rënia e *ë*-së un dore ka sjellë edhe zgjatimin e zanores së theksuar të temës. P.sh. zgje-

dhimi i I-rë; *djēg, djērg, līdh, mār, mbjēll, mbūsh, ndāl, sōs, shkīm, zgtēdh* etj.; zgjedhimi i II-të *jēt, llomīt, pjās, pōet, qīt, sherbetīs, ullašīt* etj.

Pjesorja e foljeve të zgjedhimit të tretë del me zanoren e temës, p.sh. klasa e I-rë: *bā°, ngī, hī*; klasa e II-të *la, sha, bje* (ble), *tē, pī, shūi, frīy, kie, levdue, punue, rnue, shikue, lye, thye*. Foljet e kësaj klase, që për analogji me foljet e klasës së parë të zgjedhimit të II-të në të kryerën e thjeshtë dalin me *-(j)ta* e ruajnë edhe në pjesore këtë zgjatim tematik: *fjēt, luejt, mbrojt,* *ruejt* etj.

Pjesorja e disa foljeve të klasës së dytë të zgjedhimit të IV-të dhe e disa foljeve supletive del me prapashtesën *-n*. P.sh. *nxā°n, zā°n; dhā°n, kā°n, thā°n* etj.

Në këngët popullore për foljet e zgjedhimit të I-rë e të II-të përdoret gjerësisht pjesorja me prapashtesën *-un*. P.sh. *u vran dekun pes a gasht/ ja pan sherin shtat bajrak; ka°nka ulun në katue; jā°n përpjekun në komit* etj.

Pjesorja me *-un* është e rëndomtë për stilin poetik të Veriut.

Mbiemrat e formuar nga pjesoret e foljeve të zgjedhimit të parë e të dytë dalin gjithmonë me prapashtesën *-un*: *i folun, i lagun, i pjekun, i she-titun, i vaditun* etj. Mbiemrat e formuar prej pjesoreve të zgjedhimit të tretë kanë zakonisht prapashtesën *-m*: *i punuem, i lyem, i thymem*, por: *dreqin e mallkue!*

12. *Përcjellorja* në këtë të folme ndërtohet zakonisht me pjeszën *tuj*: *tuj bā°, tuj hingllue, tuj lshue, tuj ndej* etj.

13. *Paskajorja*. Kjo e folme përdor më fort paskajoren e ndërtuar nga pjesëza me + pjesoren, p.sh. *me lyp, me lūr bjetën, me shkue, me thye* etj. Përdorimi i konstruktit *për + emër foljor asnjnës i pashquar* në vend të paskajores me *me* nuk është i dëndur. P. sh. *u nis nga Avreja per t'shkue n'Lekbibaj; nuk mujke për t' i dāl përball/ prandaj ja bā°kē kto pūn hajnish* []

Diateza Pësore

1. *E tanishmja*. Format pësore të së tanishmes nuk paraqesin ndonjë veçori dialektore me përjashtim të vetës së parë njëjës e shumës. Veta e parë njëjës merr mbaresat *-(h)em* dhe *-ena*, nga të cilat e dyta përdoret më dëndur. P.sh. *ū avytēna, nuk mun i afrohenā, po krehēna, ū kthehenā, jam ka mērzitēna, kam mbet vetēm e po mērzitēna, po šohēna, po ulēna* etj. si edhe: *avytem, gzohem, lahem, shtrihem* etj. Veta e parë shumës merr mbaresat *-(h)em(i)* dhe *-ena*, nga të cilat e dyta përdoret më rrallë. P.sh. *na avytē, gzohem, lahem, pjakemi, shtrihem, sohemi, jem ka dirgem, jem ka ngitem* etj. si edhe: *lahēna, tash merrna vesh, puqēna, rrezitēna, t'shtrēngohēna* etj.

Në të folur të shpejtë zanorja *e* e mbaresës *-ena* bie si për njëjës dhe për shumës, pra thuhet: *avytna, afrohna, krehna, gzohna, šohna* etj. Edhe zanorja *i* e mbaresës *-(h)emi* të shumës, siç shihet edhe nga shembujt, në shumicën e rasteve ka rënë.

2. *E pakryera*. Forma pësore e së pakryerës formohet me anë të pjeszës *u*, e cila u paravijet trajtave të diatezës veprorë. P.sh. *ū u lashna; ti u lashne; u marrkē kmisha gashk grosh; u nishkē rārijā, u tutkē, u ulkē; u bashkueshim; u ndrueshim, u ortakishim, u përdajshim, u avytshit; u lashin e u ndrueshin mūr/ mandej u djergshin te shpija; u mbledhshin burrat; u mbytshin t'tana, u përdashin* etj.

3. *E kryera e thjeshtë*. Forma pësore e së kryerës së thjeshtë formohet si në mbarë shqipen me anë të pjesëzës *u*. Veta e III-të njëjës pëson po ato ndryshime si në gegërishten letrare.

4. *E kryera*. Forma pësore ndërtuar me ndihmëtarin *jam* përdoret kryesisht për foljet vetvatore, p.sh. *jem llomit me të, jem pre* etj. Foljet e tjera e formojnë pësoren me anë të pjesëzës *u* që i paravijet foljes p.sh. *m'u ka a'j gondra e veshit, kur ja'n dāl nikajt n'Qaf J na u ka ba shum luft e vrās; mbasandej ju ka nis pushka; na u ka kput ymyti krejt; rrā'ja ju ka tha; na u kan sos tanve fyshekt krejt* etj.

Nuk kemi mundur të nxjerrim asnjë shëmbull për diatezën pësore të së kryerës së plotë, sepse, siç u tha edhe më lart (f. 128 § 5), kjo kohë përdoret rrallë. E kryera e plotë e dytë e formon diatezën pësore me anë të foljes ndihmëse *jam*, p.sh. *ishin kā'n vra sa ndër veti; in kā'n dēk fm̄ unit*.

5. *Mënyra urdhërore*. Në vetën e dytë njëjës të urdhërores vihet re një zgjerim i temës së foljes me *n* sipas tipit (ti) *ban* — pësore: *banu*. Kështu kemi: (ti) *gzonu, krenu, lanu* etj., por dëgjohen edhe *gzoū, shoū* etj.

Në vetën e II-tëzanorja i e mbaresës *ni* zakonisht bie: *burra shtrëngonu, mblihdnu, rroniū, ulnu* etj.

Trajta foljore aspektive. Një nga tipatet më karakteristike në sistemin foljor të kësaj së folmeje është edhe një trajtë foljore aspektive që shpreh një veprim në procesin e zhvillimit të tij e të zgjatjes në kohë (aspect duratif).

E tanishmja e kësaj trajte ndërtohet me anë të foljes ndihmëse *ja'm* plus lidhëzën ndajfoljore *ka* dhe foljen themelore në të tanishmen¹⁾ p.sh.

V. I *ja'm kā narth; ja'm kā ndieku shjartha; s'ja'm ka t'njoh; ja'm ka punoj; ja'm ka rri;* *ja'm kā shkoj nesër; ja'm ka vi prej Baram Currit* etj.

V. II *je kā ec; je kā lyp, a je kā ngitesh | a je ka dirgësh? ka je K₁ shko? a je kā ve te shpija? kā je kā ve?* etj.

V. III *ō kā bje dielli, ky ō kā m'pvet, ō kā rri ndrejt, ō kā na jep dërzhava* etj.

Shumësi

V. I *jem kā dirgem, jem kā e hjekim, jem ka ngitem* etj.

V. II *kā jeni kā shkoni?*

V. III *s'ja'n kā bojn hiš, ja'n kā shkrihen n'gaz me mue* etj.

Dënduria e madhe e përdorimit të kësaj forme është një nga tiparet që i bien menjëherë në vesh njeriut që dëgjon për herë të parë këtë të folme.

Trajta tjetër aspektive *jam + përcjelloren e foljes themelore* është mjaft e rrallë.

E pakryera e kësaj trajte mund të ndërtohet nga e pakryera ose e kryera e thjeshtë e foljes *jam* plus lidhëzën ndajfoljore *kā* dhe të tanishmen e foljes themelore. P.sh. *ishna kā punoj; ishna kā shkoj; ishna kā vi prej Baram Currit; ish kā puno; shka ish kā bā?* — *ka mbush grun n'thas; ishim kā ham cill; ishin kā punojn* etj.

kesh kā shkoj; kesh kā lidhi grunin; kesh kā punoj; ke kā puno; kem kā ham gielln; ket kā lypni; ket kā punoni; ken kā punojn; ken kā lypin etj.

1) Në të folmen e Labovës e Krvqit (lokaliteti i Libohovës) përdoret një e tanishme analitike e ngjashme me atë të Nikaj-Mërturit, ndërtuar nga folja ndihmëtare *jam*, lidhëza që dhe e tanishmja e foljes themelore: *jam që laj duart, është që ha bukë, është që shkruan* etj., por me një dënduri jo aqë spikatëse.

Nuk kemi mundur të dallojmë ndonjë nuancë kuptimore që t'i ndajë në përdorim këto dy forma analitike të së pakryerës.

Më të rrallë dëgjohej edhe një trajtë tjetër e ndërtuar nga e pakryera e foljes *jam* plus përcjelloren e foljes themelore: *û ishna tuj punue*.

N d a j f o l j a

Ndajfoljet që kemi mbledhur po i japim të grupuara sipas funksionit, duke i shoqëruar me ndonjë vrejtje.

a) *ndajfolje kohe: apet, ateri* (atëhere), *aterna, edhé, nesër prama, nesret, prap, tash, tashiti, sivjet, sonte, m̄a s'pari, me i heri, për gjith far heret etj.* Ndajfolja me origjinë sllave *apet* përdoret shumë dendur, ndërsa ndajfoljen *prap* e kemi dëgjuar vetëm një herë. Është për t'u shënuar se në lokucionin *nesër prama* ndajfolja e dytë del në formën e thjeshtë. d.m.th. pa *m*-në protetike që ka sjellë shndrimin $p > b$. Kjo formë e thjeshtë gjendet edhe në të folmet e toskërishtes jugore. Në ndajfoljet e përngjitura e lokucionet e formuara me fjalën *herë* kjo del shpesh me një *i* fundore.

b) *ndajfolje vendi: aty, gëti* (me u *shue guhen ton gëti*), *khò, kndejna, kndejnaj, nget* (afër) *përmbra* (*padi përmbra s'kam me u ba'm*), *mbrend, para, përjasht, asajt* (andej, asaj ane), *ksajt* (këtej, kësaj ane) (*kryetari i koprativs ka urredh ksajt apo jo?*) etj. Është për t'u shënuar se në këtë të folme nuk përdoret ndajfolja *afër*, por vetëm *nget*. Në krahasim me gjuhën letrare ndajfolja *kndejna* paraqitet e zgjeruar me rrokjen *-na*, kurse ndajfoljet *mbrend* e *përjasht* duken si të cinguar nga mungesa e *a*-së fundore. Është interesant edhe adverbizimi i përemrave *asajt, ksajt*. Në një fragment kënge gjejmë të përdorur si ndajfolje vendi fjalëzen te:

n'ato maje ku s'dëjet bora /
te i ka n.bledh do djelm sokola /
te i ka mbledh do djelm të ri /
zgiehdh në Jug deri n'Veri . . .

c) *ndajfolje mënyre*. Përdoren ndajfolje mënyre të formuara me prapashtesën *im* si: *fjaturim* (fluturim) *pezullim, përballim* (*i dona gjá'nat përballim* / *jo msheftas*), me prapashtesën *-shëm* si *idhnueshëm, lodhshëm* etj. Me kuptim ndajfoljor përdoren edhe mbiemrat *t'madhe, t'vogël* në shprehje si: *n'nadje u veshke nusja e ja niske brims t'madhe; nuk ndin mir pa i fol t'madhe: me fol t'vogël* / *nuk ndin*. Lokucione ndajfoljore formohen edhe prej mbiemrash të tjerë të nyjshëm p.sh. *ishna mundue per s'fortit*.

Shkalla siperore e ndajfoljeve ashtu si dhe e mbiemrave, formohet vetëm me anë të ndajfoljes *bukur: bukur i madh, dergja u bjen* [dhenve] *bukur fort, erdh lajmi bukur von* etj.

Trajta ndajfoljore të lakueshme. Disa ndajfolje përdoren edhe në forma të lakueshme si p.sh. *prej atjehit, "Bajram Curri" e merr dhe ktuhin, kumshti i djehit, s'jena t'zot e kurrkundit, s'e pake nusen deri nesret, prej qeduhiit mun i vrasim, ata baruti ish kapun me ata t'mbrendit*]] *atere u ndezke fap kta t'jashtit e e ndezke edhe ata t'mbrendit*. Përdorimi i shpeshtë i këtyre formave ndajfoljore të lakueshme është një nga veçoritë morfologjike më të dallueshme për atë që e dëgjon për herë të parë këtë të folme.

Parafjalët

Në këtë të folme parafjala *te* ka edhe një variant fonetik *tu*: *a je ka ve te shpia?* *jā^om ka rri tu shpia* (shih më poshtë sintaksën).

Parafjala *më*, e cila në gjuhën e sotme letrare është ngushtuar mjaft nga shtrirja e parafjalës *në*, këtu përkundrazi është më e përdorshme, p.sh. *m' breg t' Buens; m' bōr / m' shī e m' veri; m' kater ant, m' krue, m' lis* etj. Por përpara emrave që nisin me zanore përdoret vetëm parafjala *nd(ë)*, p.sh. *nd' ahrit kulls, nd' ar, nd' obor, nd' od t' gravet, nd' ūj*. Po kjo parafjalë, por me grupin *nd* të asimiluar në *n*, përdoret edhe para emrave që nisin me një *m ose p si rri n' mal; n' menḡes; ka shtrve zollumin n' popull* etj.

Të tjera parafjalë që paraqesin interes dialektor janë:
mbaja e përmbaja (mbi e përmbi), p.sh.: *i vndueshim i bez e fundin mbaja bezit; i ka rā orteku shpīs përmbaja mblojs;*

deri, teri, dekteri, tekteri, p.sh. *deri te trent, teri n' Ćakov, dekteri n' vitin ḡashidhet, tekteri m' Dri* etj. Në *dekteri* e *tekteri* kemi një kontaminim *tek + deri*: *tekderi*: *dekteri*: *tekteri* (khs. në gjuhën letrare *deri tek*).

Për parafjalën *prej* përdoret barabar edhe varianti i saj fonetik *pej*: *prej Karadakut, prej prronit, pej Fōngut, pej Ćakovet e pej Mitrovicet* etj.

Lidhëzat

Lidhëza veçonjëse *ndo* është mjaft e përdorëshme në këtë të folme; p.sh.: *atere ndo e tharke kos / ndo e pike; ja u ḡet ḡithcillit rob ka i ok / ka dī ok / ndo tri; dajma rokun në kto net / ndo p' e djeg katundin krejt.*

Përdorimi i fjalës *si* në vend të *që* çfaqet jo vetëm te për emri lidhor, por edhe te lidhëza ftillonjëse, p.sh. *e njeh n' kuvend si ô prej Shale; kur bje shum shi si shohen ujnāt e mdhej; shka kie Rushe si po kā^on; tutem si ôsht aty* etj.

Me kuptimin e lidhëzes krahasore si përdoret zakonisht lidhëza *sikur* p.sh. *ktu sikur Dibra nuk e bā^ojn; kthen e flet sikur vendi ktu; kur delshim te stani bashim policat / sikur jan tavalinat tash.*

Me kuptimin 'gjersa' përdoret lidhëza *kursa*: *kursa t' jen Prek Pasha gjall / m' tok t' Shpīpnīs kuj s' kam mei dhāⁿ.*

Me kuptimin *ndërsa* përdoret lidhëza *kurse*: *kurse grānke būk dazmoresha / vjedhke lugēn.*

Nga fjalëformimi.

Do të prekim këtu disa parashtesa e prapashtesa për të venë në dukje të qenët e tyre në këtë të folme dhe për të shënuar ndonjë nuancë të kuptimit të tyre.

Parashtesa *pā-* përdoret mjaft dëndur për të formuar mbiemra, sidomos prej emrash, p.sh. *i pākuvet, i pāshkoll, i pāshnet, i pūtakat, katunde t' pāvada* etj.

Prapashtesa *-esh*, që shërben për të formuar emra mocioni si *dazmoresh, kauresh* etj. i ngjitet edhe emrit *nip* duke na dhenë fjalën *nipnesh* e cila përdoret krahas fjalës *mbēs*.

Në fjalët *dushkla* (gjethe të thata të rēna në tokë), *e pendël* (pendë e vogël), shohim prapashtesën diminutive *-ël*.

Me një tjetër prapashtesë diminutive *-ez* formohen emrat e disa kafshëve shtëpijake, kur s'janë më shumë se një mot, p.sh. *edh-édhez, king-kinḡez-viš-višez.*

Me prapashtesën *-ij* formohen emrat e nocionit *mushkij* nga *mushk-u* e *ukij* nga *uk-u*; në këtë mes theksi shpërngulet nga rrënjë mbi prapashtesën. Me anë të prapashtesës *-n* është formuar mbiemri i *dhin* prej emrit *dh*. p.sh. *lesh* i *dhin*.

Prapashtesa *-ni* shërben për të formuar emra kolektivë si *nusni*, *robni*, *shpandnia*, *vllaznia* etj.

Me prapashtesën *-shëm* formohen nga pjesorja mbiemra me kuptim jo pësor, p.sh. *grue* u *besueshme* (që beson, besimtare), *ô kâ°n nieri* i *kndueshëm* (që ka kënduar), *vende t' thyeshme* (vende të thepisura, të ashpra).

NGA SINTAKSA

1) Parafjalët *te* e *tu* të rasës emërore ndahen me përdorim në këtë mënyrë² që të shënohen drejtimin për diku, kurse *tu* vendin ku ndodhet a bëhet diçka. P.sh. *a je ka ve te shpia?* atere shkueshin *te Baram Begu*; ateri dalim *te stajet*. *a kam ku vi te ju?* e *shueke* miku e *shkueke* *te miku* si i *marrke* *shikën* etj. — *jâ°m ka rri tu shpia*; *djelt i kâ°m tu shpia*; *kulašin e kishin bâ° tu burri*; *û kâ°m ardh tu ti për Baram*; *tu qai krue ki ngrë sadrat*; *nxum vend tu Prroni* i *Zogut* etj. Por kjo rregullë e përgjithëshme nuk është fare pa përjashtime; brezi i ri sidomos përdor të edhe në ato raste kur duhet *tu*.

2) Me parafjalën *për* mund të ndërtohen plotësa vendi që tregojnë vendin nepër të cilin ecën, lëviz një send, p.sh. *shket thundra për bar*; *dhe u nis për t' gat ni shpatit*, *ksaj si shkojm na tashti për t' i thon rruga thuer*; edhe i *ngulke n'dhë për rrugën si shkueke te kroni*; *dymbdhet gjajda°na jay qitke tirqet për gû etj.*

3) Parafjala *prej* mund të shënojë edhe vendin për ku drejtohet një send, një veprim, p.sh. *jena afrue na prej atyne pā na pa ata nē*; (Turgut Pasha) *e ki pa shti fuqin prej nesh*, ose mund të tregojë kohë, por për afërisht, p.sh. *e lâ°m e thahet deri nesër prej pramet*.

4) Plotësi i vendit e plotësi i mjetit në këtë të folme mund të ndërtohen edhe në rasën kallëzore pa parafjalë, p.sh. : *me shkue Kolgecaj*; *û i bie torokop krye me m'sundue ni grue*; plotës mjeti: *i bje allti n'krahuer*; *me i ra shplak*; *kur ka sjell topuz harapi* . . . ; etj. Në një këngë këtë plotës e gjejmë të ndërtuar me parafjalën *nē*: *a posjell ti n' topuz a un po sjelli?*

5) Në një tog fjalësh emër + emër në rasën rrjedhore, ky i fundit, mashkullor a femëror qoftë, përdoret më fort me nyjën e prapme *t* se sa pa këtë nyjë, p.sh: *pare arit*, *zhgun burrit*, *rrem dushkut*, *bisht kalit*, *diq unit*, *lvore verrit*, *gur zermit*; *lesh delmjet*, *buk doret*, *kullot gajet*, *cigare makinat*, *kapak përzorjet*, *dru pishet*, *skut shpijet* etj. Ndërtimet *dushk bingu*, *dushk frashni*, *mish kingi*, *uj lumi*, *pantolla zhguni*, *lesh delmje*, *tlyen lope*, *dushk shkoze* etj. në materialet që kemi mbledhur na dalin rreth tri herë më pak se të parat.

6) Emri në rasën rrjedhore njejës, kur shërben si plotës lëndë, përdoret zakonisht pa parafjalën *prej*, por me nyjën e prapme *-t*, p.sh.: *korita ô drunit*; edhe *kto drunit jâ°n*; *qiri bâ°het dyllit*; *lahutën e bâ°jn mondit e verrit e frashnit e şado t'jen*; *kto jan llastikut*; *ja ven shalën telatinit*; *i kët shp̄ e kâ°m bô zittit mir boll*; *pishet jâ°n* etj.

Plotësi i lëndës me parafjalën *prej* është i rrallë: *ja ven frënin prej şelikut*; *korita ish prej drunit*; *tāv prej bote*, *prej lvore qershije*.

7) Rrjedhorja me nyjën e prapme -t përdoret edhe si një ablativus limitationis, p.sh. *a je la ftyret?, a je la trupit?*

8) Emrat diell e *kāl*, edhe pse pas parafjaleve të kallëzores përdoren ndonjëherë në trajtën e emërores së shquar, p.sh. *e qitke m'dielli e teret; atere i qitke m'dielli e i terke; i kām m'arr me kalī.*

9) Kallëzuesi që ka si kryefjalë një emër kolektiv vihet në numrin shumë: *mileti jān hī maleve; jān vot gaja n'bjeshk; e ndoqën Krasniqja* etj. Këtu bën përjashtim emri shumic: *diq unit shumica; shumica s'iu kthyeke.*

Trajta e shkurtër e përemrit vector, që përsërit një kundrinë të drejtë të shprehur prej një emri kolektiv, vihet në numrin shumë: *fukaran i ka dasht / fukaran i ka nimue / nāna e fukaras o kān; si i kie gan.*

10) Me emra të gjinisë femërore përdoret rregullisht numrori tri: *tri fjal, tri pllamb, tri gake, tri šika* etj.

11) Periudha hipotetike. Më shpesh protaza lidhet me apodosën asintetikusht dhe ka si kallëzues një folje në paskajore, p.sh.: *me ardh senia / bō boll; me kōn dhia e smund / edhe edhe le i smund; me kān për rrobe / e vlojm [ujin]; me i qit edhe nji fije tāmel / del t'mir [kumshti]* etj. Por disa herë përdoren edhe lidhëzat *n'koft, n(ē), n'rast se*, p.sh.: *n'koft g'kyke me m'pre harapi / lot për mue ti mos me derdhun; në m'begenisi mue për mik / ma ep [vajzën] n'rast se nuk i begenisem ū atij / m'thot s'muj me ta dhān.*

12) Në tekstet e mbledhura kemi gjetur edhe këto dy anakoluta: *frati kur t'pjaket / e mbajke kuvendi; ni šik e vogël n'djep / i ka hānger thi vesh.*

LEKSIKU

Duke qënë Nikaj - Mërturi një krahinë kryesisht blegtorale, sfera e jetës baritore, e rritjes së bagëtive dhe e punimit të qumështit e leshit dallohen për një pasuri më të madhe termesh në krahasim me bujqësinë, e cila është e kufizuar vetëm në kultivimin e misrit. Përveç kësaj është për t'u venë re se, ndërsa fjalët e bujqësisë janë shumica të burimit sllav, në fjalët e blegtorisë huazimet sllave janë fare të paka. Megjithatë në leksikon e kësaj së folmeje gjenden një tok sllavizmash krahinore si *dërzhav, dever, gus, kersh, me llomit, llopar, llubenic, meti, pokrov, rok, skopec, šaranik, torisht, vad-a, vllaš-a, voshin, zit* etj. Kjo është e kuptueshme po të kemi parasysh se Nikaj-Mërturi ka pasur gjer von lidhje të ngushta me Kosovën, e cila ndodhet në kontakt të drejtpërdrejtë me botën sllave.

Turqizmat në këtë të folme janë të paka. Siç është vënë re, ndikimi turk ka prekur kryesisht sfera të jetës qytetare¹⁾, pra krahinat malore gati e veçuar e Nikaj-Mërturit, duke qënë dhe e gjitha katolike, nuk është prekur aq shumë nga ky ndikim sa krahinat muslimane të Shqipërisë së Mesme (khs. *M.I.Çeliku*, "Vërejtje mbi të folmen e Dumresë" në Buletin i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore 3. 1963 f. 239; *B. Beci*, "Hulumtime gjuhësore në Mat" po aty f. 258). Si turqizma krahinore për Nikaj-Mërturin mund të përmendim vetëm fjalët *šibrit* (çibrit 'shkrepse') *dallash* e ndonjë formulë urimi si

— *Byjrem, hoshgelden u koft!*

— *Allahrazolla.*

Të tjera turqizma nga sfera ushtarake, jeta shtetërore e shoqërore etj. dëgjon vetëm nga goja e pleqve sidomos, kur kujtojnë ndonjë ngjarje të kohës së sundimit turk.

Në leksikun e kësaj së folmeje kemi konstatuar një numër fjalësh; (shqipe ose huazime), të cilat i ka me po ato kuptime edhe Jugu, sidomos ai ekstrem, ndërsa në krahinat e Shqipërisë së Mesme, me sa dimë ne, ato ose nuk përdoren fare, ose janë mjaft të rralla; p.sh. *ahër-ahri* (tosk. ahur) *avulli-a* (tosk. avlli), *bõt* 'baltë', *bucël*, *drugëz*, *fëlqi*, *gaz* 'vaj guri', *gûrr-a*, *japi* (në kuptimin ndërtesë, bina), *katue*, *kesh* (qesh, tall një njeri), *kotec*; *kurpën* (tosk. kulper), *me lnûr* (tosk. llanaris, nga llanar 'gërhanë'), *plaf*; *sokak*, *telatin* etj.

Mbiemrat *i epër* e *i poshtër* përdoren jo vetëm në toponimet *Curraj i Epër*, *Curraj i Poshtër*, por edhe në çdo rast tjetër p.sh. *guri i epër*, *guri i poshtër* (në mulli). Fjalët 'i sipërm' e 'i poshtëm' kjo e folme nuk i njeh.

Ka në këtë të folme disa fjalë të mbarë gjuhës, por që këtu kanë marrë ndonjë kuptim të ri, p.sh. *shalqan* 'pjepër', kurse shalqinit i thonë *llubenic*, ose *bâth* 'fasule', *patërzhona* 'domate'; *ajk-u* quhet yndyra që lëshon leshi kur lahet, ndërsa *ajka* e qumshtit quhet *mâz-a*; *taçi* quhet kashta e misrit ose sana që është bërë mullar, kurse fjala *mullar* shënon strumbullarin e mullarit. Fjala *vatër* ka marrë një kuptim më të gjërë dhe shënon gjithë dyshemenë e "kuzhinës", e cila është e shtruar me baltë të gatuar; fjala *pod* shënon edhe dyshemenë (kur është e shtruar me dërrasa) edhe tavanin. Mbiemri *i verdhë* ka kuptimin i gjelbër, kurse *sari* = i verdhë.

Këto janë disa vrejttje të shkurtëra e të përgjithëshme që dalin nga një vështrim i shpejtë mbi materialin leksikor që kemi mbledhur në atë krahinë.

KONKLUZION

E folmja e Nikaj-Mërturit është pa dyshim një e folme geqe veriore. Siç ndodh shpesh herë, të folmet e zonave periferike ruajnë më gjatë disa tipare të vjetra të gjuhës, d.m.th. konservojnë, ndërsa në krahinat qëndrore lindin zhvillime, që me kohë nisin të përhapen në gjithë truallin gjuhësor të një dialekti o kryedialekti. Si ruajtje të një gjëndjeje më të vjetër gjuhësore nga e folmja Nikaj-Mërturit mund të përmendim: në *vokalizëm* grupet zanore *ie*, *ue*, *ye* dhe në *konsonantizëm* grupet *mb*, *nd*, *ng*. Dihet se gegërishtja e folur e krahinave qëndrore e veriperëndimore grupet zanore të mësipërme i ka reduktuar në *i*, *u*, *y*, dhe grupet *mb*, *nd*, *ng* me anë të asimilimit progresiv i ka kthyer në nazale të thjeshta me disa variacione lokale.

Të folmet e gegërishtes veriore në bazë të disa tregonjësish kryesisht fonetikë, po edhe morfologjikë ndahen në dy grupe: lindor e perëndimor. Përsa i takon pyetjes se cilit prej këtyre dy grupeve i përket kjo e folme, një analizë e fakteve gjuhësore më të qenësishme na tregon se në të ka tipare lindore, perëndimore dhe ndonjë dukuri që nuk merr pjesë as në njerin as në tjetrin grup, po na kallëzon një fazë të moçme të përbashkët; gjejmë gjithashtu dhe disa tipare që janë karakteristike ose e kanë zanafillën në zonat lindore.

*Tipare të përbashkëta me grupin verilindor.*¹⁾ Në *vokalizëm*:

